


ZGJEROHEN KATEGORITE QE DO TE PERGJOHEN ▶ FAQE 2-3

DRAFTI, DESHMITARE ANONIME DHE ZARFE SEKRETE KUNDER BANDAVE

Zbardhet Kodi i ri i Procedurës Penale, përgjime për çdo vepër penale të kryer me mjetet e telekomunikimit

NGA ADRIATIK DOÇI



[SHQIPTARJA.com]

SHQIP ARKIVA

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VI - NR. 107

E SHTUNË, 07-05-2016

www.shqiptarja.com

ZGJEDHJET NE PARTI

KANDIDATET PER KRYETAR TE PS NE 61 BASHKITE

Fillon gara në bazë, lobime me deputetë dhe ministra për testin e Kryesisë

NGA ESIONA KONOMI

▶ F 9

DESHMIA E KAMARIERIT



"VRASESI MU DUK SI SHITES CIGARESH"

Zbardhet rrëfimi i kamariertit të lokalit ku u vra Elton Çiça. Prokuroria: Ja si Alban Trimi fshehu pistoletën

NGA ELTON QYNO

▶ F 6-7



PASURITE

SHEIKET E KUVENDIT, "KAUBOJSI" ME 20 SHTEPI

Pronat dhe llogaritë e Astrit Veliajt, pasuria Doshit, Topallit, Blushit, Palokës dhe Strazimit. Ja kush janë deputetët më të pasur dhe të varfër të Parlamentit

▶ FAQE 4-5

Ditari i luftës, Haki Stërmilli: E vërteta e mbledhjes së Mukjes

▶ F 18-19

Kuvendi: Spiunët kundër zyrtarëve me pasuri të fshehur

▶ F 10

Meta mesazh Kongresit të SHBA: Me ju kundër terrorizmit

▶ F 11



KASTRIOT ISLAMI: "DREJTËSIA" PREK EDHE DEKRIMINALIZIMIN E MEDIAVE

NGA DENIS MINGA

▶ F 13

policor, i krijuar me ligj, kanë të drejtë të kërkojnë përgjimin, për të siguruar të dhënat e domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore. Ndërkaq, Prokurori i Përgjithshëm ose, në mungesë të tij, prokurori i autorizuar prej tij, pas shqyrtimit të kërkesës me shkrim të Drejtorit të SHISH-it, Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Mbrojtjes ose Ministrit të Drejtësisë, miraton ose refuzon kërkesën për përgjimin e telekomunikimeve nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit.

Pronat dhe llogaritë e Astrit Veliajt, pasuria e Tom Doshit

Pasuria e Jozefina Topallit, Ben Blushit dhe Edi Palokës, kush janë deputetët më të varfër

ADRIATIK DOÇI
TIRANË

Deputeti i Partisë Demokratike, Astrit Veliajt, gjatë vitit 2015, ka deklaruar pranë ILDKP blerjen e një sipërfaqeje trualli dhe ndërtese në shumën 130 mijë euro. Po ashtu, Veliajt deklaroi se ka marrë 1.54 për qind të aksioneve të shoqërisë "Stamles", 64 mijë euro dhe 1 711 338 lekë. Deputeti demokrat thotë se ka lënë si garanci 15 prona të tij për një kredi të marrë tek një person juridik. Deputeti nuk e deklaroi shumën e kredisë, por numri i pronave të vendosura si kolateral, nënkupton se bëhet fjalë për një shumë të madhe. Ndërkaq, bashkëshortja e Veliajt, Adelina Kristo Veliajt, deklaron gjendjen e likuiditeteve në bankë në shumën 491,329 lekë si dhe të ardhura nga



Tom Doshi



Astrit Veliajt

paga si administratore e UFO-s, 959,784 lekë. Ndërkaq, deputeti Tom Doshi deklaroi shkëmbimin e një apartamenti, shitje kuotash kapitali në vlerën 35,000,000 lekë, shitblerje pasurish të paluajtshme

në vlerat 78,615,600 lekë, 150,000 lekë, 150,000 lekë dhe 150,000 lekë. Po ashtu, Doshi deklaroi të ardhura nga qeraja në Australi, fitim nga shoqëria Aldosch, 4 020 729 lekë, fitim nga shoqëria Antibiotik, 16

Astrit Veliajt

Astrit Veliajt ka deklaruar pranë ILDKP blerjen e një sipërfaqeje trualli dhe ndërtese në shumën 130 mijë euro. Deputeti deklaroi se ka marrë 1.54 për qind të aksioneve të shoqërisë "Stamles", 64 mijë euro dhe 1 711 338 lekë.

Tom Doshi

Doshi deklaroi se ka marrë hua në shumën 50 mijë euro, 106 940 000 lekë dhe 54 mijë euro. Po gjatë vitit, 2015 deputeti ka shlyer borxhet në shumën 7 000 000 lekë, 17 729 060 lekë, 258 mijë euro, 59 mijë euro dhe 11 950 000 lekë.

050 342 lekë, fitim nga shoqëria Profarma, 76 149 478 lekë, fitim nga shoqëria Galaxy, 15 225 050 lekë etj. Tom Doshi thotë se ka marrë hua në shumën 50 mijë euro, 106 940 000 lekë dhe 54 mijë euro. Po gjatë vitit, 2015 deputeti Doshi deklaroi se ka shlyer borxhet në shumën 7 000 000 lekë, 17 729 060 lekë, 258 mijë euro, 59 mijë euro dhe 11 950 000 lekë.

DEPUTETË ME PASURI MODESTE

Disa ligjvënës shqiptarë deklaroi vetëm pagat. Kështu, deputetja deklaroi të ardhurat nga paga si

deputete 1,563,336 lekë si dhe nga puna në Universitetin e Elbasanit, 980,000 lekë. Ndërsa deputeti Gent Strazimiri thotë se ka marrë dy overdrafte 500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë. Deputeti deklaroi një shtesë prej 70,208,89 lekësh në një llogari bankare si dhe të ardhura nga paga dhe shpërblym, 2,443,827 lekë. Ndërkaq, kryetari i grupit parlamentar të PD, Edi Paloka deklaroi se ka shitur makinën 5 mijë euro, pagën si deputet 2,556,247 lekë, pagën e bashkëjetueses nga puna si bibliografe në Shkollën e Magjistraturës etj.

PASURIA E ASTRIT VELIAJT

Pjesë trualli plus ndërtesë, 1.5 % pjesë e pronës me sipërfaqe prej 1372 m3 truall dhe 1372 m2 ndërtesë, 130 mijë euro. Burimi të ardhurat nga qeratë.

Marrë në pronësi 1.54 % të aksioneve të shoqërisë "Stamles", nëpërmjet kontratave me persona të tretë. 64 mijë euro dhe 1 711 338 lekë.

Gjendja e likuiditeteve në bankë me datë 31.12.2015, 18,687,208 lekë

Gjendja e likuiditeteve në cash, 240,000 lekë

Të ardhura nga paga si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, 2,363,527 lekë

Të ardhura nga interesa, 117,165 lekë

Të ardhura nga qeratë, 25,708,700 lekë

Garanci 15 prona për një kredi të marrë tek një person juridik

BASHKËSHORTJA ADELINA KRISTO VELIAJT

Gjendja e likuiditeteve në bankë, 491,329 lekë, burimi nga paga dhe karta krediti

Të ardhura nga paga si administrator i subjektit UFO sh.p.k, 959,784 lekë

PASURIA E TOM DOSHI

Akt shkëmbimi pasurie të paluajtshme, apartament dhe truall ndërtesë

Kontratë shitblerje kuotash kapitali, 35,000,000 lekë

Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, 78,615,600 lekë

Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, 150,000 lekë

Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, 150,000 lekë

Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme, 150,000 lekë

Të ardhura nga paga si deputet, 1,547,045 lekë

Të ardhura nga paga, bashkëshortja, 7 649 910 lekë

Të ardhura nga dhënia me qara në Australi, 15 mijë USD

Të ardhura nga shpërndarja e fitimit nga shoqëria Aldosch, 4 020 729 lekë

Të ardhura nga shpërndarja e fitimit nga shoqëria Antibiotik, 16 050 342 lekë

Të ardhura nga shpërndarja e fitimit nga shoqëria Profarma, 76 149 478 lekë

Të ardhura nga shpërndarja e fitimit nga shoqëria Galaxy, 15 225 050 lekë

Të ardhura nga qeraja, 6 mijë euro

Të ardhura nga dëmshpërblimi i mjetit, 5,000,000 lekë

Të ardhura nga qeraja, 4,8 milionë euro

Shlyerja e kësteve të kredisë, shlyer 3 584 lekë

Marrje huaje, 50 mijë euro

Marrje huaje, 106 940 000 lekë

Marrje huaje, 54 mijë euro

Kthim huaje shoqërisë, 7 000 000 lekë

Kthim huaje shoqërisë, 17 729 060 lekë

Kthim huaje shoqërisë, 258 mijë euro

Kthim huaje shoqërisë, 59 mijë euro

Kthim huaje shoqërisë, 11 950 000 lekë

PASURIA E JOZEFINA TOPALLIT

Paga si deputete, 2,395,000 lekë

Pension mujor si kryetare e Kuvendit, 71,960 lekë

Ndoc Topalli, bashkëshorti, shkëmbim prone dhe pjesë takuese

Të ardhura nga aktiviteti provat si noter, 476,000 lekë

Të ardhurat nga qeratë e ndryshme nga pronat e trashëguara, 1,360,000 lekë

Margerita Topalli, e bija, të ardhura nga paga në BSH, 1,000,000 lekë

Llogari e re bankare, 10 mijë USD

PASURIE E EDI PALOKËS

Shitje makine, 5 mijë euro

Paga dhe të ardhura si deputet, 2,556,247 lekë

Desara Mema, bashkëjetuesja, të ardhura nga puna si bibliografe në Shkollën e Magjistraturës, 586,785 lekë

Kleta Paloka, vajza, të ardhura nga paga si juriste, 275,400 lekë

PASURIA E DEPUTETIT GENT STRAZIMIRI

Shtesë në llogarinë bankare, 70,208,89 lekë

Të ardhura nga paga dhe shpërblym, 2,443,827 lekë

Overdraft me limit, 500,000 lekë

Overdraft me limit, 1,000,000 lekë

PASURIA E DEPUTETES ARBJOLA HALIMI

Të ardhura nga paga si deputete, 1,563,336 lekë

Të ardhura nga puna në Universitetin e Elbasanit, 980,000 lekë

PASURIA E DEPUTETIT BEN BLUSHI

Llogari rrjedhëse e pagës nga Kuvendi, 4 224 578 lekë

Obligacione sipas ankandit..., 29 000 000 lekë

Depozitë në euro, 12 118,27 euro

Llogari bankare, pakësuar me 470 euro

Llogari bankare, pakësuar me 508 euro

Llogari bankare, 27,735 USD

Llogari bankare, 1,012,753 lekë

Të ardhura nga paga, 2,466,113 lekë

Pagesa nga e drejta e autorit nga UET, 2,000,000 lekë

Të ardhura nga interesat e obligacioneve, 2,437,986 lekë

Të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere, 1,700,000 lekë

Shlyerja kredie për banim, shlyer 288,000 lekë

Natali Blushi, fëmijë madhor, blerje pasurie të paluajtshme në Korçë, 30 mijë euro

Të ardhura nga qeraja e ambientit të mësipërm, 710,000 lekë

Llogari bankare, 524,859 lekë

PASURIA E DEPUTETIT AQIF RAKIPI

Kontratë për dhënie huaje, 190 mijë euro

Blerje automjeti, 32 mijë euro

Gjendje cash zvogëluar, 5 mijë euro

Të ardhura nga funksioni si deputet, 2,419,701 lekë

Të ardhura nga paga e bashkëshortes si financiere tek shoqëria Halili, 840,000 lekë

Sheikët e Parlamentit, pasuria e "Kaubojsit", dhjetëra shtëpi

Ja deputetët më të pasur të Kuvendit të Shqipërisë

ADRIATIK DOÇI
TIRANË

Troje, dhjetëra apartamente, aksione, të ardhura nga qiratë, huamarrje dhe transaksione qindra mijëra euro. Kjo është vetëm maja e ajsgërgut pasurisë së akumuluar gjatë vitit 2015 nga disa deputetë të Parlamentit Shqiptar, sidomos ligjvënësit biznesmenë. Deputeti Eduard Ndocaj, i njohur ndryshe në rrethet politike dhe mediatike edhe si "Kaubojsi", në deklaratën e pasurisë për vitin 2015, deklaroi 14 apartamente në Shëngjin me sipërfaqe 725,92 m², me një vlerë 23,580,220 lekë. Pranë ILDKP, Ndocaj ka deklaruar edhe një shtëpi private në Sarandë, me sipërfaqe 600 m², plus 1200 m² truall, me vlerë 100 mijë euro. Deputeti deklaroi edhe dy dyqane në Lezhë me sipërfaqe



Eduard Ndocaj

259 m², me vlerë 10,360,000 lekë, një tjetër apartament në Lezhë me sipërfaqe 69 m², me vlerë 2,000,000 lekë. Deputeti deklaroi dy një apartamente në Tiranë me sipërfaqe 320,30 m² dhe 94,3 m², si dhe një bodrum me sipërfaqe 666 m², me vlerë 496 mijë euro. Po ashtu, deputeti Ndocaj deklaroi dy apartamente në Itali me sipërfaqe 480 m² dhe 180 m²,



Koço Kokëdhima

me vlerë 650 mijë euro dhe 300 mijë euro. Në deklaratën e pasurisë, Ndocaj deklaroi edhe një truall në Shëngjin me sipërfaqe 120 m², me vlerë 2,000,000 lekë si dhe një tjetër dyqan në Lezhë, me sipërfaqe 57 m², me vlerë 2,280,000 lekë. Po ashtu, deputeti deklaroi edhe 16 mijë metra katrorë tokë të trashëguar. Ndocaj deklaroi apartament dhe dyqan edhe në emër të bashkëshortes. Sipas deklaratës zyrtare të pasurisë, Ndocaj deklaroi një kredi në shumë 325 mijë euro, Kreditin e ka marrë në vitin 2002, nga e cila ka shlyer 280 mijë euro. Po ashtu, Ndocaj deklaroi edhe dy kredi të tjera në vlerat 185 mijë euro dhe 435 mijë euro.

KOÇO KOKËDHIMA

Deputeti i Partisë Socialiste, Koço Kokëdhima, për vitin 2015, deklaroi shtatë aksione, rritje të kapitalit në shoqëritë aksionere, të ardhura nga qiratë etj. Konkretisht, Kokëdhima deklaroi shite të 100 për qind të aksioneve në një shoqëri aksionere, me vlerë 15,000,000 lekë, likuidim pjesor i detyrimit nga person fizik, 50 mijë euro dhe 7,000,000 lekë, rritje kapitali në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 6,030,000 lekë, rritje të numrit të aksioneve në shoqërinë aksionere, 26,500 lekë, shtim të gjendjeve kreditorë në kompani të ndryshme me 8,000,987 lekë, 20,127,920 lekë, 4,642,889 lekë dhe 1,871,650 lekë. Në deklaratën e pasurisë, deputeti Kokëdhima deklaroi të ardhura nga dhënia e ambienteve me qera në shumat 399,500 lekë, 51,000 lekë dhe 51,000 lekë. Ndërkohë, në emër të bashkëshortes, deputeti Kokëdhima deklaroi disa paga si administratorë e shoqërive të ndryshme në shumat 720,326 lekë, 851,939 lekë, 46,550 lekë, 38,640 lekë dhe 956,340 lekë. Zonja deklaroi edhe 340,445 lekë të ardhura të përfituara nga Sigal për rimbursim dëmi si dhe lëvizje llogarish, Vajzat, Bora, Besa dhe Era deklaroi llogari bankare, blerje makine, të ardhura nga pagat etj.

PASURIA E DEPUTETIT EDUARD NDOCAJ

14 apartamente në Shëngjin me sipërfaqe 725,92 m ² , 23,580,220 lekë
Shtëpi private në proces legalizimi në Sarandë 600 m ² plus 1200 m ² truall, 100 mijë euro
Dy dyqane në Lezhë me sipërfaqe 259 m ² , 10,360,000 lekë
Apartament në Lezhë me sipërfaqe 69 m ² , 2,000,000 lekë
Kontratë sipërmarrje me... apartament në Tiranë 320,30 m ² , bodrum në Tiranë me sipërfaqe 666 m ² , apartament në Tiranë, 94,3 metra 2, 496 mijë euro
Truall në Shëngjin, 120 m ² , 2,000,000 lekë
Dyqan në Lezhë, 57 m ² , 2,280,000 lekë
16 mijë metra katrorë tokë të trashëguar
Apartament 480 m ² , në Itali, 650 mijë euro
Apartament në Itali me sipërfaqe 180 m ² , 300 mijë euro
Paga si deputet, 122,901 lekë, plus 34,035 karburant, plus 17,000 lekë telefon
Kredi në shumën 325 mijë euro që në vitin 2002, shlyer 280 mijë euro
Huamarrje në vlerën 185 mijë euro, shlyer 130 mijë euro
Huamarrje në vlerën 435 mijë euro, shlyer 300 mijë euro
Bashkëshortja, dy dyqane në Lezhë me sipërfaqe 69 m ² , 10,360,000 lekë
Apartament në Lezhë me sipërfaqe 69 m ² , 2,000,000 lekë

PASURIA E KOÇO KOKËDHIMËS

Shitje tek individët të 100 për qind të aksioneve në shoqërinë aksionere..., 15,000,000 lekë
Likuidim pjesor i detyrimit nga person fizik, 50 mijë euro dhe 7,000,000 lekë
Rritur kapitali zotëruar në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 6,030,000 lekë
Rritur numri i aksioneve në shoqërinë aksionere, 26,500 lekë
Pakësuar gjendja e llogarisë rrjedhëse bankare 250,2012 lekë
Pakësuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 2,167,112 lekë
Shtuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 8,000,987 lekë
Shtuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 20,127,920 lekë
Pakësuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 4,672,085 lekë
Pakësuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 4,971,889 lekë
Shtuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 4,642,889 lekë
Krijuar gjendje kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 1,871,650 lekë
Të ardhura nga paga si deputet, 1,435,585 lekë plus 661,000 lekë
Të ardhura nga dhënia e ambienteve me qera, 399,500 lekë
Të ardhura nga dhënia e ambienteve me qera nga shoqëri aksionere, 51,000 lekë
Të ardhura nga dhënia e ambienteve me qera nga shoqëri aksionere, 51,000 lekë
Shtuar gjendja kreditorë në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, 54,430 lekë
Bashkëshortja, Brixhilda Kokëdhima, gjendje kreditorë në shoqëri aksionere, 413,246 lekë
Pakësuar gjendja në llogarinë bankare, 172,426 lekë
Të ardhura nga paga si administratorë, 720,326 lekë
Të ardhura nga paga si administratorë, 851,939 lekë
Të ardhura nga paga në shoqërinë..., 46,550 lekë
Të ardhura nga paga në shoqërinë..., 38,640 lekë
Të ardhura nga paga në shoqërinë..., 956,340 lekë

APARTAMENTET
Deputeti Eduard Ndocaj, i njohur ndryshe në rrethet politike dhe mediatike edhe si "Kaubojsi", në deklaratën e pasurisë për vitin 2015, deklaroi 14 apartamente në Shëngjin me sipërfaqe 725,92 m², me një vlerë 23,580,220 lekë.



THIRRJE PËR APLIKIME NR.2 - Leviz Albania

"Leviz Albania - Demokracia Vendore në Veprim", është një projekt që synon të ketë efekt katalizator për demokracinë vendore në Shqipëri.

Leviz Albania është një projekt i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri dhe zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare, "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partners Albania" dhe "Co-PLAN". Leviz Albania përmes "Thirrjeve për Aplikim" synonin kurajimin dhe mbështetjen e OJF-ve dhe individëve që nxisin ndryshimin dhe kultivojnë aksionin dhe ndjenjën komunitare.

Leviz Albania fton organizatat joftimprurëse, individët dhe grupimet e individëve që janë faktorë apo aktorë ndryshimi në komunitetet e tyre të marrin pjesë në "Thirrjen Nr.2" për Aplikime që Leviz Albania ka shpallur. OJF-të, individët dhe grupimet e tyre ftohen të marrin pjesë me një **KONCEPT IDE** duke përzgjedhur njërin nga dy drejtimit e mëposhtme:

1. Advokaci dhe lobim për përmirësim, ndryshim apo zbatim të suksesshëm të politikave vendore përmes rritjes së përgjegjëshmërisë të përfaqësuesve të institucioneve publike.

2. Rritja e llogaridhënies së zyrtarëve vendor të zgjedhur dhe të emëruar.

Koncept-idetë sëbashku me dokumentacionin shoqëruar i gjëni në faqen e internetit www.levizalbania.al.

Afati i fundit i pranimit të koncept-ideve është:

DATA 18 MAJ 2016, ORA 17:00


LIMITET E GRANTEVE JANË:

ORGANIZATAT JO FITIMPRURËSE: NGA 5,000 DERI NË 50,000 CHF (FRANGA ZVICERANE)

INDIVIDËT: NGA 500 DERI NË 20,000 CHF (FRANGA ZVICERANE)

Një individ mund të aplikojë në emër të një grupi qytetarësh aktivë në komunitet që përbëjnë një grup interesi, pavarësisht nëse ky grup është i regjistruar ose jo në gjykatësi OJF. Për më shumë informacion mbi formatin e koncept-idesë, dokumentacionin e nevojshëm dhe hapat e "Thirrjes Nr.2" ju ftojme të vizitoni faqen e internetit www.levizalbania.al ose duke na shkruar/kontaktuar në adresën:

Leviz Albania - Demokracia Vendore në Veprim
Rruga: Bardhok Biba, Pallati: TREMA/B; Hyrja 25, Tiranë
Telefon: 044 500 153; E-mail: info@levizalbania.al



■ LËVIZIN TRUPIN

Të dy së bashku e ulin të qëlluarin me armë zjarri në dyshemenë e lokalit me shpinë mbi pllaka dhe kokë nga banaku i lokalit.

■ HAKMARRJA

Pas vrasjes së Robert Ramës, me sa duket hakmarrja ka vijuar duke ekzekutuar Elton Çiçan. Policia s'ka asnjë të dyshuar për këtë vrasje.



Elton Çiça

(në rreth) Vrasësi që qëlloi Elton Çiçan

Robert Rama

Prokuroria: Ja si u zhduk nga polici arma e Elton Çiços

Alban Trimi fshehu pistoletën, iku në varrim në Tepelenë

ELTON QYNO
TIRANË

Prokuroria e Tiranës zbardh të plotë dinamikën e zhdukjes së pistoletës dhe telefonit të viktimës Elton Çiça, të vrarë në 1 maj në ambientet e lokal "De Niro". Sipas prokurorit Enklit Gjini, ka qenë oficeri i policisë Alban Trimi që së bashku me personin tjetër në tavolinë, Redi Renja kanë zhdukur sendet personale dhe një armë pa leje të viktimës Çiça. Pas marrjes së armës, Alban Trimi e ka futur atë fillimisht në xhep dhe më pas në brez, duke u larguar nga Tirana në drejtim të Tepelenës, ku dhe ka marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të viktimës. Trimi është arrestuar gjatë rrugës në kthim, pas një urdhëri ndalimi të lëshuar nga Prokuroria e Tiranës. Për shtetasin Alban Trimi, me funksion oficer policie në Komisaratin nr.5, në Tiranë, prokuroria ka ngritur tre akuza si "Kryerja e veprimeve që pengojnë zbulimin e të vërtetës", "Shpërdorim i detyrës" dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarakë dhe municionit". Viktima Elton Çiça, dyshohet si autor i vrasjes së Robert Ramës në Durrës, pasi mendohet se ky i fundit i kishte grabitur dhe rrahur prindërit në Tepelenë. Pas vrasjes së Ramës, me sa duket hakmarrja ka vijuar duke ekzekutuar Elton Çiçan.

■ JA SI U ZHDIK PISTOLETA

Nga kopyja e pamjeve të sigurisë, prokuroria e Tiranës ka ngritur dyshimet ndaj këtij personi, nisur nga sa vijon: Në datë 1 maj 2016 rreth orës 22:20 në rrugën "Gjin Bue Shpata" në afërsi të shkollës "Emin Duraku" në mjediset e brendshme të Bar "De Niro" ka ndodhur një vrasje. Viktima

është identifikuar si shtetasi Elton Çiça. Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të janë sekuestruar pamje filmike të kamerave të lokalit, ku rezultojnë se në momentin e ngjarjes viktimën Elton Çiça, ndër të tjera ka qenë në një tavolinë me punonjës të policisë Alban Trimi. Nga kopyja që ju bë këtyre pamjeve filmike video ka rezultuar se: "...një nga personat e ulur në tavolinë me të quajturin Alban Trimi dhe personin mbi të cilin u qëllua me armë zjarri pistoletë, kthehet tek tavolina ku ishin ulur para se të qëllonin me armë dhe nga çanta që është në krah të djathtë të personit që u qëllua, merr një send në formën e pistoletës dhe del nga dera sipër së cilës duket se është vënë kamera regjistruese ku më parë doli edhe shtetasi Alban Trimi. Pastaj kthehet shërisht tek vendi ku ka mbetur gjysëm i shtrirë mbi divan shoku i tyre i qëlluar me armë zjarri, ulët në anën e tij të majtë ku më parë ishte ulur shtetasi Alban Trimi dhe ndërkohë duket se në duar para, mbi prehër, mban ende sendin si pistoletë të cilin më pas e lë diku në krahun e tij të majtë në një vend, ku këndi i fokusimit të kamerës nuk regjistron. Pastaj e kap me të

Rezultojnë se në momentin e ngjarjes viktimën Elton Çiça, ka qenë në një tavolinë me punonjës të policisë Alban Trimi

dy duart shokun e tij të qëlluar me armë zjarri dhe mundohet ta ulë në dysheme por nuk ja arrijn dot i vetëm dhe në ndihmë i shkon shtetasi Alban Trimi. Të dy së bashku e ulin të qëlluarin me armë zjarri në dyshemenë e lokalit me shpinë mbi pllaka dhe kokë nga banaku i lokalit.

■ E FUTI NË XHEP, IKU NË VARRIM

Ndërkohë, shtetasi Alban Trimi shkon tek tavolina ku ishin ulur, merr disa sende dhe i vendos në xhepin e majtë të pantallonave të tij dhe del nga dera në krah të majtë të banakut e kthehet shërisht në lokal dhe në këtë moment dallohet se në xhepin e djathtë të pantallonave të tij ka një celular ngjyrë të zezë. Pastaj shkon tek vendi ku pak më parë personi tjetër la sendin si pistoletë e merr atë e kalon në pjesën para brezit nga përpara dhe më dorën e djathtë e fut në pjesën e pasme të brezit nga e djathta duke përdorur edhe dorën e majtë për ta sistemuar në brezin e pantallonave nga pas. Pas kësaj del nga fokusimi i pamjeve filmike dhe nuk kthehet më në këtë vend ku për pak kohë vinë punonjësit e policisë...". Nga të dhënat paraprake të vendit të ngjarjes ka rezultuar se në vendngjarje nuk është gjetur aparati i telefonit që duhet të ketë përdorur viktimën si dhe nuk është sekuestruar as sendi, që nga pamjet video duket se ka qenë armë zjarri pistoletë, në cantën e viktimës, të cilën fillimisht e ka marrë personi i ulur përballë tij i identifikuar si Redi Renja e që më pas e ka marrë duke u larguar nga lokali i quajtur Alban Trimi, punonjës policie. Nga verifikimet paraprake rezultojnë gjithashtu se Alban Trimi nuk gjendej në territorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, por ishte larguar të mëtejshme prej nga ku do të kthehej pas varrimit të viktimës Elton Çiça.

Efektivi mohon akuzat

Gjykata mbyll në qeli Trimin, Oficeri: Kam kryer arrestime model

Ish-shëfi i antidrogës në kryeqytet Alban Trimi do të qëndrojë në qeli me masën e sigurisë "arrest me burg" dhënë nga Gjykata e Tiranës. Gjyqtari Asim Vokshi, zhvilloi seancën gjyqësore me dyer të mbyllura, duke pranuar kërkesën e prokurorisë, për vlefësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës shtrënguese, atë të "arrestit me burg". Para gjyqtarit të masave, mësohet se oficeri Trimi ka mohuar fshehjen e sendeve personale të Elton Çiços dhe ndërhyrjen apo prishjen e provave në vendin e ngjarjes. Edhe avokati mbrojtës mbajti të njëjtin qëndrim, duke pretenduar se oficeri Alban Trimi dhe dentisti Redi Renja kanë tentuar ti japin ndihmën e parë mjekësore shokut të tyre, Elton Çiça. Avokati i kujtoj gjykatës, punën e lavdërueshme që oficeri Alban Trimi ka bërë gjatë ushtrimit të detyrës, ku mes tjerash ishte edhe operacioni i arresimit të rreth 30 personave në Tiranë, për shpërndarje e

shitje të lëndëve narkotike. Ish-shëfi i antidrogës në kryeqytet me ndihmën e avokatit, kërkoi të lirohet nga gjykata me pretendimin se është i pafajshëm. Por ky pretendim, mësohet se u kundërshtua nga prokurori Enklit Gjini. Ai lexoi para gjyqtarit Vokshi, përshkrimin e veprimeve të oficerit Alban Trimi dhe dentistit Redi Renja të figuara nga kamera e sigurisë së lokalit, pas vrasjes së shokut të tyre Elton Çiço. Sipas prokurorisë, fillimisht ka qenë dentisti Renja që ka hequr pistoletën e Elton Çiços nga çanta duke vendosur në një cep të lokalit. Ku pak sekonda më pas, pasi kanë lëvizur viktimën nga vendi i vrasjes në dysheme, prokurorët thonë se oficeri Trimi e ka marrë atë bashkë me aparatën celular dhe është larguar nga lokali. Pak minuta më pas, ai është marrë në pyetje për disa orë dhe më pas është lënë i lirë për t'u arrestuar dy ditë pas ngjarjes për tre akuza.



Alban Trimi





Momenti i vrasjes së Elton Çiços në zonën e ish-Bllokut në Tiranë

HETIMET/POLICIA ASNJE PERSON TE ARRESTUAR

Vrasja e Çiços në ish-blok autori mund të jetë ish-police

Një efektivi policie mund të jetë autori i vrasjes së 35-vjeçarit Elton Çiçajt në ish-blok. Këto dyshime, kanë lindur pas analizimit të pamjeve filmike të autorit të krimit, i cili reagon me shumë qetësi dhe qëllon njëherësh me shumë qetësi. Për më tepër se 48 orë, policia nuk ka qenë në gjendje të identifikojë dhe arrestojë autorët e krimit të rëndë, ndërkohë që deri ditën e sotme uniformat blu kanë bërë vetëm shoqërimin e disa personave, si të dyshuar. Burime pranë policisë thanë për "Shqiptarja.com" se autori i krimit e ka njohur viktimën dhe se ai duhet të ketë pasur një kohë të mjaftueshme për të vëzhguar të gjitha veprimet e tij. Për më tepër, sipas policisë autori i krimit ka pasur dijeni se objektivi i tij Elton Çiça lëvizte i armatosur, dhe për këtë ai ka marrë të gjitha masat që ekzekutimi të bëhej në një ambient publik, pikërisht aty ku Çiça ndihej më i sigurt. Ky vend është zgjedhur me qëllim që viktimë mos kishte asnjë mundësi të



reagonte apo të kuptonte diçka kundër tij. Dhe në fakt ashtu ka ndodhur. Autori, që në dukje është profesionist ka qëlluar nga afër me armë zjari në mes të lokalit Elton Çiçajn, duke i shkakuar këtij të fundit dy plagë të rënda. Autori i krimit është larguar me vrap pa u ndaluar nga askush. Mësohet se mes të shoqëruarëve është edhe i dyshuari për grabitjen e prindërve të Çiçajt, Ervis Imeri si dhe disa familjarë të të vëllait Roberto Rama, i ekzekutuar në qershor të 2015, gjithashtu i dyshuar për grabitjen e famijes Çiça. Pak orë pas

publikimit të pamjeve të kamerave të sigurisë së lokalit ku ndodhi vrasja e Elton Çiçajt, policia nxorri një urdhër shoqërimi për pronarin e lokalit, Lorenc Sallakun. Lajmi u bë i ditur për mediat nga policia e kryeqytetit. Sipas saj, Sallaku është kërkuar të shoqërohet në ambientet e drejtorisë së Policisë së Tiranës, për të dhënë sqarime në lidhje me publikimin e videos si dhe të bashkuara, duke argumentimi i shoqërimin të tij sipas burimeve të policisë është se ai ka kryer veprimet që dëmtojnë sekretin hetimor duke publikuar fotot dhe pamjet.

Kamarieri: Mu krijua përshtypja se ishte shitës cigaresh

Rrëfimi i kamarierit të lokalit "De Niro" "Dorën ku mbante pistoletën e fshehu nën çantë"

ELTON QYNO
TIRANË

"Mu krijua përshtypja se ishte shitës cigaresh apo shpërndarës picash. Jam larguar me vrap sapo dëgjova krismën e parë në lokal. Ika me shpejtësi dhe gjatë vrapimit jashtë lokalit jam rrëzuar, duke menduar se më ka qëlluar dhe mua...". Kështu e nis dëshminë e tij para oficerëve të policisë kamarieri i lokal "De Niro", i cili thihet nga klientët me emrin Xhino. I riu ka qenë ngjitur në banak, kur ka vënë re hyrjen me qetësi të personit që ka qëlluar dy herë me armë mbi Elton Çiçajn, duke e lënë të vdekur në vend. I tronditur, ai është larguar në drejtim të daljes së lokalit dhe ka vrapur, por papritur është rrëzuar dhe ka menduar se është qëlluar nga autori. Ndërkohë që ka vënë re se edhe persona të tjerë vraponin për tu larguar. Në polici ai ka treguar se në momentin kur autori i krimit ka hyrë në lokal, atij i ka lënë përshtypjen e një personi që shet cigare apo një personi që shpërndan pica, pasi dhe veshja ishte e thjeshtë.

DËSHMIA E KAMARIERIT

Gazeta "Shqiptarja.com" mëson rrëfimin e kamarierit Xhino që ka dhënë në polici, duke rrëfyer me detaje atë që kishte parë mbrëmjen e 1 majit në lokal "De Niro" në zonën e ish-bllokut ku mbeti i vrarë Elton Çiça. Xhino, ka rrëfyer para oficerëve të policisë se përgjithësisht e diela e 1



Lokal "De Niro" ku u vra Elton Çiça

majit ka qenë shumë e qetë dhe nuk ka konstatuar asnjë gjë të dyshimtë si jashtë por edhe brenda ambjentëve të lokalit. Kamarieri ka shtuar se punon prej disa kohësh në këtë lokal, dhe se pronari i tij është Lorenc Sallaku. Më tej ai shton se personat që ishin ulur në tavolinën me Elton Çiçën i

njihte si klientë të rregullt të lokalit, pasi prej mëse dy muaj ata e frekuentonin shpesh këtë lokal. Xhino, ka rrëfyer për policinë se nuk kishte të dhëna se kush ishin ata dhe me çfarë mereshin. Kamarieri ka shtuar se: "... në momentin e ndodhjes së krimit kam qenë pranë banakut të lokalit.

Largimi

Më tej ai ka shtuar se nuk ka parë armën dhe është larguar, por vetëm kur ka dëgjuar krismën e pistoletës është larguar në mënyrë të menjëhershme.

Kam parë një person me kapele dhe që në brez mbante të lidhur një çantë tip "Marsup", ngjyrë të zezë. Personi kishte pak mjekër dhe se ka hyrë në lokal pa përhëndetur askënd. Nuk i kam kushtuar shumë vëmendje, pasi që në kontaktin e parë kur e kam parë këtë person, më është krijuar përshtypja se është ndonjë person që shet cigare apo ndonjë që shpërndan pica. Kjo përshtypje, më është krijuar nga mënyra e të veshurit të tij dhe ecja. Pasi shitësit e cigareve futën në lokale vazhdimisht, pa pyetur kamarierët apo pronarët e bareve, duke u drejtuar

direkt tek klientët, ku i kërkojnë t'i shesin paketa cigareje. Ata mbajnë në trup dhe çanta, dhe nga këto detaje mendova se ishte shitës cigaresh apo shpërndarës picash"-ka deklaruar në polici Xhino, kamarieri i lokalit "De Niro". Më tej ai ka shtuar se autori i krimit gjatë ecjes ka mbajtur të dy duart para dhe të bashkuara, duke i mbuluar me marsupin që kishte lidhur në brez. Pyetjes së oficerëve të policisë nëse autori ishte me dy pistoletë ose jo, pasi nga pamjet filmike duket sikur mban një pistoletë të dytë në brez, kamarieri është shprehur se nuk ka pa pasur pistoletë tjetër të future në brez. Pasi shënja e zezë ka qenë rripi i lidhur nga prapa shpinës i çantës marsup. "Sapo është afëruar ka qëlluar duke mos i thënë asnjë fjalë personave që ndodheshin në tavolinë. Më tej nuk ka parë asnjë gjë se çfarë ka ndodhur pasi jam larguar me shpejtësi. Në ikje e sipër jam larguar duke u rrëzuar në ambientin jashtë të lokalit, ku kam mendur se isha qëlluar dhe unë. Në ikje e sipër kam humbur dhe portofolin, ku mbaja lekë të xhiros ditore të lokalit, ku me sa di ishin rreth 400 mijë lekë të vjetra"-ka treguar kamarieri. Ky i fundit ka shtuar se kur është rikthyer në lokal ka parë që ambienti ishte i rregullt, pasi ishin thyer disa sheshe vere dhe vendi i tavolinës dhe kollitku ku qëndronte viktimë i shtrirë ishte mbuluar me gjak. Kamarieri ka shtuar në polici se nga persona të tjerë kishte mësuar se disa klientë ishin fshehur në tualetin e lokalit, dhe mes personave që ishin fshehur aty ishin gazetari Spartak Koka dhe një mikeshë e Luan Ramës, e cila punon në gjykatë.

LSI fut përsëri në garë të rinjtë për drejtimin e Forumit

Klevi Pojana dhe Floida Kërpaçi kandidatë për të pasuar Braimllarin

ESIONA KONOMI
TIRANE

NISMAT

Lëvizja Rinore për Integrim, forumi i të rinjve të LSI-së, do të ketë së shpejti një kryetar të ri, i cili do të pasojë në këtë detyrë Erisa Xhixhon dhe Endrit Braimllarin. Dje janë zyrtarizuar dy kandidatë. Ata janë Klevi Pojana dhe Floida Kërpaçi, e cila së fundmi është dhe anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës. Në çelje të një procesi të tillë, Kryetari i LSI-së, Ilir Meta mori pjesë në Konventën Kombëtare të Gjinnazistëve të organizuar nga Lëvizja Rinore për Integrim. Meta deklaroi se vendi ka nevojë të ecë më shpejt drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Arritja e këtij objekti kërkon një progres më të vendosur në drejtim të sundimit të ligjit dhe të shtetit të së drejtës. Meta theksoi se

Për të vendosur një raport të ri të politikës me qytetarët është themelore vendosja e standardeve më të larta të transparencës dhe në këtë drejtim LSI do të vazhdojë t'i thellojë të gjitha nismat e saj të bëra publike

kryeqështja dhe kryeprioriteti sot mbetet miratimi pa vonesë i reformës në drejtësi. Sipas tij, LSI është shprehur qartë se mbështet dhe voton ndryshimet kushtetuese që i hapin rrugë reformës në drejtësi. "Për të vendosur një raport të ri të politikës me qytetarët është themelore vendosja e standardeve më të larta të transparencës dhe në këtë drejtim LSI do të vazhdojë t'i thellojë të gjitha nismat e saj të bëra publike. I kërkoj sot përpara jush edhe deputeteve tona më të reja, por

edhe LRI-së, që të ndërmarrin iniciativa sa më konkrete në këtë drejtim, sepse në radhë të parë standardet më të larta duhet t'i kërkojnë të rinjtë. Në këtë kuadër do të ndërmarrim nisma për të rishikuar dhe përmirësuar legjislacionin për financimin e partive dhe të organizatave politike, për të marrë përvojat më të mira evropiane dhe amerikane të auditimit për transparencë, për fondet apo aktivitetet e forcave politike dhe shpenzimet e fushatave, për të bërë ndryshime sa më të qenësishme në Kodin Zgjedhor, për të garantuar shenjtërinë e votës të qytetarit shqiptar anëtarë vendit. Për këtë qëllim deputetët përfaqësues të LRI-së në Kuvendin e Shqipërisë do të ndërmarrin një nismë ligjore konkrete, sikurse bënë edhe për Ligjin dhe Vullnetarizmin", deklaroi Kryetari i LSI-së, Ilir Meta gjatë Konventës Kombëtare të Gjinnazistëve të organizuar nga Lëvizja Rinore për Integrim.



Ilir Meta në Konventën Kombëtare të Gjinnazistëve të organizuar nga LRI

KREU I LSI

Meta deklaroi se vendi ka nevojë të ecë më shpejt drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror. Arritja e këtij objekti kërkon një progres më të vendosur në drejtim të sundimit të ligjit dhe të shtetit të së drejtës



Erisa Xhixhon, Klevi Pojana dhe Floida Kërpaçi

ARTIKULLI/ CITOHEM GAZETARE, BIZNESMENE E DIPLOMATE

BBC: Shqipëria e do BE, Veliaj shihet kryeministër i ardhshëm

BBC i kushton Shqipërisë dhe dëshirës së saj të madhe për të qenë pjesë e familjes europiane një artikull të plotë. Gazetari Andrew Hosken i ndodhur në Tiranë ka intervistuar mjaft politikanë dhe figura publike të vendit tonë një ndër të cilët është edhe kryebashkiaku Erion Veliaj. Sipas gazetarit Veliaj shihet gjerësisht si kryeministri i ardhshëm i vendit. Në bashkëbisedim me gazetarin Veliaj

thotë se "Evropa nuk mund të konkurrojë me Rusinë me avionë dhe bomba. Është diplomacia marrëveshja ajo që e bën Europën kjo që është sot. Nuk ka avantazhe nga të qenit një geto, dhe Ballkani Perëndimor është sot një geto e rrethuar nga Bashkimi European. T'i thuash

dikujt që është në epiqendër të jetës publike europiane se jeta është më e mirë në stolat e pasmë të Evropës dhe larg vendimmarrjes, kjo kërkon shumë besim," shton Veliaj. Shqipëria është shndërruar në debatin kryesor dhe si një kartë e cila po luhet në Britani për të mbështetur apo kundërshtuar daljen e mbretërisë nga Bashkimi European. Në shkrim citohet gazetari Alekandër Furxhi sipas të cilit do të duhet një dekadë përpara se Shqipëria të anëtarësohet me kushtet e reja që kërkojnë qdo vit. Shqipëria ky vend i vogël i Ballkanit për një kohë të gjatë ka qenë i izoluar nga bota duke u konsideruar Koreja e Veriut e Europës. Pas kësaj periudhe vijon shkrimi i politikanët e korruptuar dhe gjyqtarët e kanë vështirësuar integrimin me pjesën tjetër të Europës. Madje shumë prej themeluesve komunist janë ende në pushtet. Shqipëria e sheh anëtarësimin në BE si simbol se dekadës së izolimit po

i vjen fundi. Sipas sondazheve të fundit më shumë se 90% e shqiptarëve duan të jenë pjesë e BE por ende vuajnë nga hijet e të kaluarës. Shqipëria nuk mund të të eksportojë direkt në vendet e BE. Shkrimi i BBC citon më tej kreun e Dhomës së Tregtisë Nikolin Jaka sipas të cilit nëse

vendi ynë do të bëjë një gjë të tillë do të kishte një impakt të madh sidomos në produktet agrikulturore. Ndërsa ambasadorja e BE në Shqipëri Romana Vlahutin shprehet se korrupsioni në politik dhe në drejtësi mbeten pengesat kryesore të së ardhmes së Shqipërisë.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë menaxher marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

- Të ketë arsim të lartë
- Të ketë përvojë pune
- Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën:
marketing@shqiptarja.com

Urimi

Joleza Koka:
Ishalla ne me djalë e ju me vajzë



Joleza Koka

Menjëherë me zyrtarizimin e kandidaturave për drejtimin e Lëvizjes Rinore për Integrim, ka përhëndetur dhe kryetarja në largim e FRESH-it, Joleza Koka. Ajo ju uron suksese kandidatëve, falënderon kryetarin aktual dhe po ashtu shfaq edhe preferencë për fituesin. "Suksese të dy kandidatëve për kryetar të LRI, koordinatoren e studentëve Floida dhe atë për gjinnazistët Klevi. Përzemërsisht urime dhe Endrit Braimllari për seriozitetin, përkushtimin dhe frymën e bashkëpunimit që ka pasur gjatë viteve të tij si drejtues i LRI. Ka qenë një kënaqësi për ne si FRESH të kishim mundësi të sillnim së bashku në Tiranë të rinjtë socialistë nga e gjithë bota për Kongresin e IUSY (once in a life kind of event), dakortësimin për kontratën sociale si dhe fushata qytetare të për-bashkëta, veçanërisht për zgjedhjet lokale. Jam e sigurt që vullneti i mirë dhe pozitiviteti do të na ndihmojë edhe për kauza të tjera në të ardhmen. Për hir të barazisë gjinore ishalla ju me vajzë dhe ne me djalë këtë herë :))"-shkruan Joleza Koka, Kryetare e FRESH.



Ja kandidatët socialistë në 61 bashkitë e vendit

Fillon gara në bazë, lobime me deputetë e ministra për testin e Kryesisë

ESIONA KONOMI
TIRANE

Kryesia e re e Partisë Socialiste miratoi në mbledhjen e saj të parë një udhëzim, sipas të cilit do të zhvillohen zgjedhjet brenda partisë për zgjedhjen e 61 krerëve të degëve. Sipas këtij udhëzimi, Asambleja Socialiste e Bashkisë do të mbledhet për të miratuar kandidaturat e mundshme, dhe do t'ja dërgojë ato Kryesisë së PS brenda datës 17 maj. Më pas do të jetë kryesia e madhe e partisë ajo që do të bëjë seleksionimin përfundimtar dhe kandidaturat e miratuara do të hidhen në garë në bazë për tu zgjedhur brenda datës 25 maj. Në këto kushte, në bazën socialiste ka filluar tashmë gara mes pretendentëve, të cilët kërkojnë jo vetëm propozimin në bazë, por edhe mbështetjen e ministrave dhe deputetëve për të marrë miratimin e kryesisë përpara se të hidhen në garën me votë në asamblenë e Bashkisë. Shqiptarja.com sjell tabelën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur ambicie në 61 bashkitë e vendit, teksa emra të tjerë mund të jenë surprizë e këtij procesi.

UDHËZIMI

Në udhëzimin e kryesisë janë përcaktuar dhe kriteret për krerët e degëve, të cilat bazohen nga degët. Sipas këtij udhëzimi, kandidatët për kryesimin e degëve duhet të kenë vendbanim ligjor dhe të bëjnë jetën e partisë për një periudhë jo më pak se një vit brenda territorit të bashkisë, të jenë anëtarë të partisë për një periudhë jo më pak se tre vjet si dhe të plotësojnë kushtet e integritetit moral. Ai është funksionar me kohë të plotë në parti, dhe nuk mund të kryejë funksione të tjera. "Kryetari i Partisë i Bashkisë zgjidhet me votim nga mbledhja e zgjeruar e Asamblesë Socialiste të Bashkisë. Këshilli Koordinues i Qarkut organizon procesin për propozimet e kandidatëve nga këshillat socialiste të njësive administrative dhe pasi bën verifikimin për plotësimin e kushteve, ja paraqet ato kryesisë"-thuhet në udhëzim. Kryesia e re e Partisë Socialiste do të mund të shkarkojë kryetarët e zgjedhur në krye të degëve socialiste të partisë, në rast se ata nuk janë eficientë në detyrën që ju është besuar. Kufizimi i të drejtës së tyre për tu promovuar mund t'i bëjë



NDREU

Pas shkrirjes së degës së PS-së Tirana-Rreth, deputetët Pjerin Ndreu i është besuar një detyrë e re, ajo e ringritjes së strukturave të PS-së në degën e Fushë-Arrësit.

CARA

Kryetari i PS-së për Kavajën, Cara ka ftohur marrëdhëniet me punët e partisë pas mosmarrëveshjeve me Elvis Roshin. Ai ka braktisur prej muajsh edhe jetën parlamentare.

ata neglizhentë në drejtimin e partisë, ndaj është marrë masa që ata të jenë në presionin e një vendimi shkarkimi nga kryesia.

TË PRIVUARIT

Deputetët dhe kryebashkiakët nuk do të lejojnë të garojnë për postin e drejtuesit të degës së bashkisë për Partinë Socialiste. Ndryshimet finale të Statutit të PS-së që u miratua gjatë Kongresit të marsit, i konsideron këto pozicione të papajtueshme, madje ka vendosur që kreu i PS-së të mos jetë i punësuar në pozicione drejtuese shtetërore, por të jetë një i punësuar i partisë, që do të paguhet me fondet e kësaj të fundit. Ky rregull përjashton nga e drejta e rizgjed-

hjes, një grup deputetësh dhe kryebashkiakësh që aktualisht po drejtojnë disa degë të rëndësishme të PS-së. Kështu, deputeti Namik Kolpliku, i cili deri më tani drejton degën e PS-së për Shkodrën, nuk do të jetë më pjesë e garës. Po ashtu edhe kolegu i tij i Qarkut të Dibrës, Ulsi Manja nuk do të mund të kërkojë një mandat tjetër për drejtimin e degës. Në garën për qytetin e Durrësit do të jetë i privuar kryetari aktual, deputeti Gentian Bejko. Dega e rrethinave të Tiranës, do të shkrihet, dhe bashkë me të edhe deputeti Pjerin Ndreu, nuk do të jetë pjesë e garës. Prej kohësh deputeti Ndreu është dërguar në Fushë-Arrëz, ku po punon për forcimin e kësaj dege të partisë. "I privuari" më i rëndësishëm duket se do të jetë Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, i cili nuk do të mund të drejtojë degën më të madhe të PS-së, atë të kryeqytetit. Megjithatë, ai ka një detyrë partiake më të rëndësishme, rolin e koordinatorit për rajonin Tiranë-Durrës. Në këtë kontekst, pushteti i tij politik do të nëqel, madje duke përfshirë edhe qarkun Durrës. Në Kavajë nuk do të mund të kandidojë deputeti Parid Cara, i cili kohët e fundit, për shkak të mosmarrëveshjeve të tij me kryebashkiakun e Kavajës, Elvis Roshin, është shmangur nga punët e partisë, madje nuk është i pranishëm as në jetën parlamentare, ku në shumicën e seancave, mungon. Në Lushnjë, deputeti Bujar Çela s'do të mund të drejtojë këtë degë të partisë. Një tjetër

SHKODER

Malësi e Madhe
Lulzim Zara
Skënder Hoti
Bashkim Cupaj

Shkodër
Rozafa Zmijani
Andi Halluni
Luan Heta

Vau i Dejës
Mark Zhuri

Pukë
Marash Kola

Fushë-Arrëz
Paulin Peraj

KUKES

Kukës
Tatjana Kagili
Ladimir Spahiu
Shemsi Shahu

Has
Liman Morina

Tropojë
Mujo Gostunari
Violeta Imeraj
Vladimir Kolana

LEZHE

Lezhë
Ermal Pacaj
Gjergj Prendi
Altin Shtjefni

Kurbin
Agron Ivanaj
Anton Brozi
Alfred Prodan

Mirditë
Pjetër Pjetri

DIBER

Dibër
Shukri Xhelili
Alma Selami
Agron Cara
Meriz Shehu

Klos
Valbona Kola

Mat
Agron Malaj

Bulqizë
Lefter Alla

Adhurim Lika

DURRES

Durrës
Natasha Paço
Alban Ramohitoj
Alfred Mullaraj

Krujë
Ilir Loci

Shijak
Tauland Xheraj
Dorina Curri

TIRANE

Tiranë
(Pritet të funksionojë me kryetar për cdo njësi administrative)

Vorë
Gëzim Demiraj

Kamëz
Zjarrm Shehu
Elton Shahini
Ramadan Cani

Kavajë
Aqif Pera
Valbona Mustafa
Tahir Kanapari

Rrogoshinë
Haxhi Memolla
Margarita Dedej

ELBASAN

Peqin
Bukurosh Maçi
Fatos Tabaku

Elbasan
Blerina Kamani
Altin Ago
Ardit Demiri
Ndrim Hysa

Librazhd
Sokol Skura
Mehmet Bicaku
Fatbardha Qatja

Gramsh
Tajar Bici
Klodjan Tase
Edmond Hida

Belsh
Alma Maksuti

Bujar Blloku

Përrenjas
Nuri Belba
Teuta Luka

Çërrik
Jetmir Laroshi
Regiana Hida

FIER

Lushnjë
Lindita Buxheli
Erjon Vodo
Arjan Cakalli

Fier
Xhavit Bushaj

Mallakaster
Pajtim Ismaili

Divjake
Naumka Aliaj
Ylli Stambolliu

Patos
Kastriot Beharaj
Albiona Camaj

Roskovec
Eleni Goga
Ilirjan Muska

BERAT

Kuçovë
Sybi Shehu

Ura Vajgurore
Petref Sula

Berat
Arben Baxhia
Shkëlqim Brisku
Visho Bizhaku

Polican
Astrit Hasa

Skrapar
Fatos Hasanaj

KORÇE

Pogradec
Bledar Çomo

Maliq
Orlind Demollari

Korçë
Ylli Ndini

Devoll

Pellumb Agolli

Kolonjë
Ilirjan Hyseni

Pustec
Jani Ago

GJIROKASTER

Tepelenë
Dino Selimi

Këlcyrë
Jonian Harkaj

Përmet
Miranda Habili
Gentiana Jahja

Gjirokastër
Jani Duri
Dashi Qeli

Libohovë
Lindita Rova
Skënder Seferi

Vladimir Hide
Sofia Abdi

Dropull
Panajot Lulo

Memaliaj
Edmond Harizi
Muharrem Agaj

VLORE

Vlorë
Anduel Tahiraj
Evis Alushi
Edmond Leka

Selenicë
Ardit Xhafaj

Himarë
Jani Gjicali

Sarandë
Jonida Abduli

Delvinë
Majko Majko
Laureta Alimani

Finik
Ziso Nasho

Konispol
Jetmira Kaso
Edlir Avdi

deputet që nuk do të jetë pjesë e garës, është Ilir Xhakolli i cili aktualisht drejton degën e PS-së për Pogradecin. Në të njëjtin pozicion nëqel dhe deputeti Ilir Pendavini, që drejton degën e PS në Korçë, por për shkak të mandatit, nuk

ka të drejtë të kërkojë votat për degën e partisë. Në Librazhd kryetari aktual i degës së PS-së, Kastriot Gurra është zgjedhur kryebashkiak, dhe si i tillë nuk do të jetë pjesë e garës. Kryebashkiakja tjetër që aktualisht drejton një degë të PS-së, është

Luljeta Dollani. Ajo nuk do të garojë më për bashkinë e Gramshit si kryetare e degës së PS-së. Ndërkohë, individë me kontribute ndër vite në PS, apo të ardhur rishtaz dhe me ambicie, kanë filluar të llobojnë brenda anëtarësisë së njësive.

■ SERVERAT

Kuvendi nxit zgjidhjen ligjore të një kërkesë të vetë ILDKP-së, mbi të të drejtën e hyrjes në serverët shtetërorë për të marrë informacion

■ MEDIA INVESTIGATIVE

Forcimi i mëtejshëm i urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë dhe publikë

Kuvendi: Spiunët kundër zyrtarëve me pasuri të fshehur

Rezoluta për ILDKP: Sinjalizuesit të vendosen në funksion të hetimit të zyrtarëve



Kreu i ILDKP, Shkëlqim Ganaj

ESIONA KONOMI
TIRANE

Kuvendi kërkon që spiunët e aktivizuar përmes paketës ligjore të quajtur "sinjalizuesit" të vihen në funksion të zbardhjes së pasurive të zyrtarëve që e kanë fshehur atë. Kuvendi miratoi këtë të enjte rezolutën për Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Deklarimit të Pasurisë, ku rekomandohet përdorimi i bilbilfrýrësve si mjet për të përmirësuar punën e këtij institucioni. "Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2016, kërkon nga ILDKPKI të ketë në fokus të punës së tij :

Marrjen e masave dhe fillimin e përgatitjeve, përcaktuar në ligjin e ri "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" me qëllim zbatimin e tij. Përcjelljen e propozimit nga ILDKPKI për burime financiare e njerëzore sipas zhvillimit të procedurave buxhetore për t'u miratuar në Kuvend me qëllim mundësimin për zbatimin efikas të ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Thuhet në rezolutë. Veç të tjerash, Kuvendi nxit zgjidhjen ligjore të një kërkesë të vetë ILDKP-së, mbi të të drejtën e hyrjes në serverët shtetërorë për të marrë informacion. "Kërkojmë: Fokusimin në drejtim të sigurimit të aksesit të drejtpërdrejtë në database-n elektronike dhe in-

stitucionet kyç, për konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave dhe evidentimit të ndryshimeve të nevojshme nëse legjislacioni aktual ka qenë pengesë për mosrealizimin e këtij rekomandimi në të shkuarën; Vazhdimi i ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimi i mëtejshëm i urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimi i mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave private. Garantimin e forcimit të pavarësisë dhe integritetit institucional dhe vazhdimin

me vendosmëri të luftës kundër korrupsionit, në radhët e administratës publike në përgjithësi, por më veçanërisht në rrahët e zyrtarëve të lartë, gjyqtarë dhe prokurorë"-thuhet po ashtu në rezolutën e miratuar nga Kuvendi. Më tej, vihet theksi tek investimi më i lartë, e po ashtu tek kujdesi i lartë ndaj bashkëpunimit me prokurorinë. "Kërkojmë: Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve investuese me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe zbatimin e një politike efektive masash për çdo rast të lidhur me to. Ushtrimin e të drejtës për ankimim bazuar në kodin e procedurës penale lidhur me vendimet e mosfillimit të procedimit penal dhe pushimit

të çështjes nga organi i akuzës. Përmirësimi i sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklarimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës të Inspektoratit të Lartë, duke shkuar drejt deklarimit online me mbështetjen e donatorëve dhe ekspertizës së huaj. Kuvendi nxit dhe mbështet ILDKPKI në forcimin e bashkëpunimit me zyra homologe dhe institucione të tjera jashtë vendit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave, praktikave më të mira apo informacioneve që synojnë zgjerimin e hapësirave investigative të hetimit të pasurive të fshehura apo të padeklaruara të zyrtarëve jashtë vendit"-përfundon rezoluta.

BERLINI/ EVROPA S'DO TË JAPË AQ PARA SA FANTAZOJMË

Lejet online, Kryeministri Rama: Ndërtimet pa leje zhvleftësuan planet

I pranishëm në konferencën ndërkombëtare "Lejet online të ndërtimit për një rajon me konkurrencës", kryeministri Rama tha se ky projekt është me vlerë për të rritur bashkëpunimin rajonal dhe për këtë arsye është historik. Shkriu e kufijve në rajon tha Rama është me rëndësi dhe fitimprurës për tregtinë duke shtuar se ky shërbim është një hap përpara, me ndryshimet dramatike që ka pësuar territori. "Lejet e ndërtimit është një hap përpara që Shqipëria bën dhe shkon në një drejtim si në vendet e tjera. Shqipëria ka një trashëgimi shumë të rëndë në raport me bazën e të dhënave me pronën dhe territorin. Territori ka pësuar një ndryshim dramatik, me afro 400 mijë ndërtime pa leje, që i kanë zhvleftësuar strategjitë dhe planet në letër dhe i kanë hedhur në lumë të gjitha paratë për plane e

→ HARITO

"Ky dixhitalizim prek në radhë të parë bizneset, që nga regjistrimi i tyre, prokurimet publike, tatimet që kanë të gjitha procedurat online dhe një sërë shërbimesh të dedikuara për ta".

strategji, pasi zhvillimi në territor ka qenë më i shpejtë sesa aktivizimi i planeve. Nëse do bënim një muze të Shqipërisë së planeve në këto 25 vite, dhe Shqipërisë reale, do shihnim dy botë paralele", u shpreh Rama. Ai foli për procesin e Berlinit, për të cilin tha se nuk është një garë ku vendet vrapojnë për të marrë sa më shumë para. Rama tha se qeveria shqiptare po ndjek një rrugë dhe se deri tani ka qenë më shpejt se Bashkimi



Edi Rama në konferencën "Lejet online të ndërtimit për një rajon me konkurrencës"

Evropian. "Ta çmontojmë idenë se procesi i Berlinit është një garë ku vendet vrapojnë kush të marrë më shumë para. Nuk

është kështu. Ne kemi vendosur një hartë për rrugën që do të ndjekim dhe deri tani kemi qenë më shpejt se BE. Ne e kemi

të nevojshme të vrapojmë, ata jo. Ata janë në një situatë të ndërlikuar dhe mbështetja që i kanë dhënë procesit është i një rëndësie të jashtëzakonshme, por paratë do të vijnë pjesë-pjesë dhe nuk do të jenë kurrë aq sa imagjinon fantazia jonë kolektive. Ka diçka më të rëndësishme, ajo që mund të bëjmë pa para për të prodhuar më shumë para", tha Rama. Ndërsa Ministria e Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermeni tha se lejet elektronike ose e-Lejet janë një hallkë e rëndësishme e planifikimit të zhvillimit urban. Sipas Gjermenit, ky shërbim thjeshton procedurat për investitorët dhe qytetarët për lejet e ndërtimit. "Ky aktivitet do të shërbejë edhe si një platformë për të intensifikuar marrëdhëniet mes vendeve të rajonit. Shqipëria ka hyrë tashmë në një rrugë në fushën e planifikimit të zhvillimit urban që garanton mbrojtjen e trashëgimisë

→ GJERMEI




"Krijimi i sistemit elektronik, është një hallkë e domosdoshme pas nismave historike të ndërmarra në fushën e planifikimit. Ofrimi i këtij shërbimi, thjeshtëson procedurat për investitorët".

kulturore. Krijimi i sistemit elektronik, është një hallkë e domosdoshme pas nismave historike të ndërmarra në fushën e planifikimit. Është pjesë e platformës e-Albania. Ofrimi i këtij shërbimi, i cili thjeshtëson procedurat për investitorët dhe qytetarët, është bërë realitet që prej 20 prillit", tha Gjermeni. Edhe Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito tha se ky shërbim do të përshpejtojë edhe procesin e anëtarësimit të vendit në BE.

Ftesa

Hajdeni të na vizitoni dhe do të shihni një shtet në lëvizje, i cili ka potencial për të lëvizur më shpejt përpara me më shumë transparencë, më shumë sundim të ligjit



Ilir Meta

Mezazhi

Meta është shprehur se ndjehet shumë i nderuar që do të zhvillojë takime të ndryshme në SHBA, ndërkohë që ka falënderuar Amerikën për mbështetjen që i ka dhënë Shqipërisë në vite

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta i ka dërguar një mesazh nga Shqipëria Kongresit amerikan, vetëm pak kohë përpara vizitës që ai do të zhvillojë në SHBA, ku garanton se Shqipëria do të vijojë që të mbetet në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në luftën ndaj terrorizmit që kërcënon jo vetëm SHBA, por të gjithë vendet e botës. Ky mesazh i kryeparlamentarit Meta është zbardhur nga e përditshmja "The Huffington Post" e cila ka dhënë detajet e këtij mesazhi që Ilir Meta i'u ka dërguar kongresmenëve dhe ligjvënësve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përveç kësaj, Meta është shprehur se ndjehet shumë i nderuar që do të zhvillojë takime të ndryshme në SHBA, ndërkohë që ka falënderuar Amerikën për mbështetjen që i ka dhënë Shqipërisë në vite, ndërkohë që thekson se, këtë pranverë Shqipëria festoi 25-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike me vendin tonë. Por ai nuk lë pa përmendur edhe krizën humanitare të refugjatëve, ku thotë se kjo është një sfidë e përbashkët dhe se për zgjidhjen e çështjes duhet një bashkëpunim shumëpalësh.

Ja mesazhi i Ilir Metës drejtuar Kongresit Amerikan:

Është një nder që të jesh në kryeqytetin e vendit tuaj, duke u përgatitur për të takuar shumë nga ju nga të dyja anët e këtij spektri, sikurse anëtarë të kësaj administrate si dhe miq nga Shqipëria brenda dhe jashtë qeverisë suaj. Unë vij si lider i organit parlamentar në një demokraci të pjekur shpejt, e cila është një mik i mirë dhe i besuar i Shteteve të Bashkuara. Një gjë e tillë do të ishte e pa mendueshme përpara rrezimit të Bashkimit Sovjetik dhe shpërbërjes së Jugosllavisë afro çerek shekulli më parë. Këtë pranverë ne festuam së bashku 25 vjetorin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis vendeve tona. Fatë mbështetjes së vendit tuaj të madh, ne kemi përshkuar një rrugë të gjatë dhe që prej vitit 2008 Shqipëria është anëtare e NATO-s.

Meta Kongresit të SHBA: Me ju kundër terrorizmit

Shkrim në "The Huffington Post" para vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës



Faksimile e shkrimit në faqen e "The Huffington Post"

humanitare dhe një katastrofë të mundshme në horizont. Dhe kur i them këto nuk flas në mënyrë figurative. Vala e emigrantëve të dëshpëruar dhe në nevojë qëndron në horizontin tonë.

Është e vërtetë që ne kemi male të larta që shërbejnë si barriera të pjesshme për të penguar kalimin e tyre. Por edhe malet e larta nuk munden që t'a ndalojnë këtë valë. Ne nuk kemi as qëllime për të ndërtuar mire për t'i penguar ata. Ne evropianët dimë diçka në lidhje me muret. Ne e dimë se muret nuk mund t'i mbajnë njerëzit jashtë, por e dimë se ato mund t'i kthejnë shtetet pas. Muret nuk mund të dallojnë njerëzit e mirë nga ata të rrezikshmit, por qeveritë sigurojnë që munden. Dhe muret, mjaftueshëm ironikisht, në fakt mundësojnë një ikje nga realiteti. Ato na lejojnë që të heqim dorë nga përgjegjësitë tona kolektive për njerëzimin dhe për njëri-tjetrin.

Por, cila duhet të jetë përgjigja jonë? Lutja ime për ju, miqtë e mi parlamentarë, është që të kujtoni një shprehje të njohur amerikane; 'le t'a përballojmë këngën së bashku'. Shqipëria është e vendosur që të bashkëpunojë nga afër me fqinjët e saj në rajonin, me partnerët në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara si dhe me shtete të tjera, për t'i dhënë përgjigjen më të mirë krizës së

emigrantëve. Por le t'a bëjmë këtë me mëshirë dhe bujari, ndërkohë që në të njëjtën kohë i japin përgjigjen e duhur. Në të kundërt, ne do të biem të gjithë, duke bërë të njëjtat gabime fatale së bashku.

Ne do t'i kapërcëjmë këto kriza. Dhe përpara se t'a bëjmë, ka shumë gjëra të cilat mund t'i bëjmë në të mirë të popujve tanë. Shqipëria ka një histori për të treguar, një histori shumë të bukur. Është një histori që tregon se si një shtet me shumicë myslimanësh shkon mjaft mirë me katolikët dhe ortodoksët. Por, shihni sa më afër nesh. Ju nuk do të gjeni një besim i cili luan një rol në drejtimin e qeverisë ose në diktimin e sjelljes së qytetarëve shqiptarë. Ne si shqiptarë jemi krenarë për harmoninë tonë fetare. Sa vende të tjera me përbërjen tonë mund t'a thonë një gjë të tillë?

Ne kemi resurse të pasqyrtëzuara duke filluar nga vetë njerëzit. Ata janë gati që të inspirohen dhe që të lëvizin përpara. Ata janë gati që të trajnohen dhe të vendosen për të krijuar kura për sëmundjet, të korra për masat si dhe makinëri për progresin teknologjik. Ky është edhe vendi ku partneriteti ynë del në skenë. Mund të jetë mjaft më përfitim për vendet tona nëse Shqipëria shënon një rritje dhe progres në një mënyrë sa më të shpejtë të mundshme. Ju keni bizneset të vogla dhe të mëdha në zonat tuaja. Thuajuni kompanive, qofshin ato agrokulturore, infrastrukturore, telekomunikacioni ose atyre që kanë të bëjnë me sistemet bankare. Tregojuni për Shqipërinë.

Hajdeni të na vizitoni dhe do të shihni një shtet në lëvizje, i cili ka potencial për të lëvizur më shpejt përpara me më shumë transparencë, më shumë sundim të ligjit, më shumë kontribute në shoqëri-në civile dhe më shumë zhvillim ekonomik, me Shtetet e Bashkuara si partner. Lutja ime për ju është e qartë. Shtetet e Bashkuara nuk duhet të rrinë thjesht e lidhur me rajonin tonë. Ajo duhet të kthehet në liderin që të gjithë presim të jetë. Disa prej nesh shpenzuan një pjesë të mirë të jetës në sisteme të turpshme të cilat na mohanin të drejtat themelore dhe lirinë. Edhe në ato ditë, ne e kemi parë gjithmonë me admirim vendin tuaj dhe po, ndonjëherë edhe me pak zili.

Ne lutemi që Shtetet e Bashkuara të mbeten shteti i cili vijon të jetë feneri ndriçues për të gjithë njerëzit në mbarë botën. Ky është momenti më i keq që vendi juaj i madh të tërhiqet nga përgjegjësia globale.

Ushtarët tanë qën-drojnë në anën tuaj në luftën kundër terrorizmit në Afganistan, Irak dhe në vende të tjera. Ne duhet që të gjithë të jemi krenarë pasi kjo reflekton një progres real në pranimin e një baze amerikane me besim në demokraci, në sundimin e ligjit si dhe duke përfunduar fjalët

shkruhen në deklaratën tuaj të pavarësisë, "Jeta, liria dhe ndjekja e lumturisë", si të drejta të patjetërsueshme.

Por, ndërkohë krahas krenarisë, ne duhet që të diskutojmë me urtësi dhe seriozitet, sfidat tona të përbashkëta. Vendi im dhe rajoni jonë janë duke vëzhguar një krizë

Ambasadorët: Miratimi i reformës hap negociatat për t'u pranuar në BE

Vlahutin dhe Hoffman e kanë lidhur reformën në drejtësi me pranimin në BE

Me të gjitha mënyrat po përpiken diplomatët e huaj t'i bëjnë presion politikës shqiptare që të miratojë sa më shpejt reformën në sistemin e drejtësisë. Si ambasadorja BE-së Romana Vlahutin, ashtu edhe Ambasadori i Gjermanisë në Tiranë, Helmut Hoffman, në dy evenimente të ndryshme janë shprehur dje se miratimi i reformës në drejtësi do të mundësojë çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

VLAHUTIN: KENI HUMBUR SHUMË KOHË

"Kenë humbur shumë kohë, por nuk do ta bëjmë reformën për ju". Vijnë tonet kritike të diplomatëve të angazhuar për miratimin e reformës në drejtësi. Deklarata vjen nga ambasadorja BE-së Vlahutin e cila së bashku me Donald Lu, kanë luajtur shpesh herë negociatorin mes politikaneve shqiptarë për këtë reformë. "Shpresoj që reforma të miratohet sa më shpejt. Kjo është një mundësi

që të marrë rekomandimin për hapjen e negociatave. Fatkeqësisht vendi juaj ka humbur shumë mundësi, shumë shanse për ndërtimin e shtetit, modernizimin dhe kjo nuk ka qenë zgjedhja juaj, por ama në këtë moment, kjo punë duhet vazhduar, dhe kjo është zgjedhja juaj. Nuk do të heqim dorë, nuk do të lodhemi dhe nuk të humbasim durimin. Keni mbështetje të plotë, por nuk do ta bëjmë ne atë që duhet ta bëni ju", u shpreh ambasadorja e BE.

KLAJDA GJOSHA

Ndërkohë, Ministria e Integritimit, Klajda Gjoshka tha thënë se një nga reformat

më të rëndësishme që do t'i japë vendit një shtytë drejt integritimit është miratimi i reformës në drejtësi, që siç tha Gjoshka, do të miratohet shumë shpejt. "Reforma në drejtësi do t'i hapë rrugë integritetit dhe besimit tek sistemi i drejtësisë. Jemi shumë pranë çeljes së negociatave si dhe shumë pranë miratimit të reformës në drejtësi. Reforma në drejtësi do të kalojë shumë shpejt. Reforma kërkon maturinë e politikës", tha Gjoshka.

HOFFMAN: NEGOCIATAT, PAS REFORMËS

Ambasadori i Gjermanisë në Tiranë, Helmut Hoff-

man, shprehet se miratimi i reformës në drejtësi do të mundësojë çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Gjatë Konferencës "Shqipëri-Serbi, drejt të ardhmes në BE", që po zhvillohet në Durrës, ambasadori gjerman theksoi se shpreson në një miratim të shpejtë të reformës në drejtësi. "Kemi shprehur besimin se do të miratohet reforma në drejtësi dhe ne shpresojmë në miratimin e saj. Kur themi reformë në drejtësi, flasim për rëndësinë e saj. Procesi për hyrjen në BE duhet kohë të zhvillohet. Nëse miratohet reforma pres që komisioni



Romana Vlahutin

të dalë në një rezultat pozitiv për hapjen e negociatave", u shpreh Hoffman. Sipas tij, procesi i integritetit kërkon kohë dhe këtë të gjithë e dinë.

META: E VËSHITRË PA AMBASADORËT

I pranishëm në këtë konferencë, kryetari i Kuvendit, Ilir Meta u shpreh se pa ndihmën e ambasadorëve, është e vështirë të cohet përpara reforma në drejtësi. "Pa ambasadorët, reformën në drejtësi

e kemi të vështirë ta çojmë përpara ndaj ne duhet të dëlohem nga komplekset", theksoi Meta. Partia Socialiste ka konfirmuar në avancë votën "pro", të njëjtën gjë ka bërë edhe LSI si dhe republikani Fatmir Mediu, ndërsa mbetet ende e paqartë vota e demokratëve. Të martën duke nisur nga mesdita ambasadorët Lu dhe Vlahutin do të marrin pjesë në mbledhjet e grupeve parlamentare të PS, PD e LSI, cilat do zhvillohen çdo 2 orë.

Letra
TIRANE

Meidani, Moisiu e Topi: Zgjedhja e Presidentit të bëhet nga populli

Përmes një letre ish presidentët shprehen lidhur me problematikën e zgjedhjes

Në kuadër të reformës në drejtësi, tre ish kryetarë shteti, Rexhep Meidani, Alfred Moisiu dhe Bamir Topi, kërkojnë zgjedhjen e Presidentit të Republikës nga populli. Përmes një letre drejtuar kryetarit të Kuvendit, Ilir Meta, grupeve parlamentare, anëtarëve të Komisionit për Reformën në Drejtësi si dhe Anëtarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore, ish presidentët shprehen lidhur me problematikën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës dhe rëndësia e zgjedhjes së tij nga populli. Sipas tyre, vetë Presidenti ka nevojë për mandat më të gjerë sesa mazhoranca e një partie apo koalicioni politik, ka nevojë për testim dhe mbështetje publike. "Zgjedhja e Presidentit direkt nga qytetarët rrit besimin e qytetarëve në sistemin politik e përfaqësues, sjell cilësi përfaqësimi, i jep fuqi dhe legjitimitet më të madh qytetar Presidentit dhe e ndihmon atë të ushtrojë më mirë dhe më me lidhje të fortë qytetare funksionet e tij kushtetuese", thuhet në letërën e ish presidentëve. Në kuadër të ndryshimeve kushtetuese dhe zgjedhore, vijon letra,

është rast të theksojmë se çështja e zgjedhjes së Presidentit të Republikës duket të jetë patjetër edhe çështje e trajtimit në ndryshimet e reja kushtetuese. "Referuar praktikave të vendeve të tjera ish komuniste me ngjashmëri në traditë apo praktikë demokratike, (Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Rumania, Bullgaria, Polonia, etj. dhe së fundi edhe Moldavia) zgjedhja e Presidentit bëhet direkt nga qytetarët, pa ndryshuar natyrën parlamentare të sistemit republikan. Për vetë traditën e brishtë demokratike, kulturën politike dhe problematikën e shumëllojshme në bashkëpunimin institucional, Shqipëria ka qenë dhe mbetet një vend që prodhon kriza politike dhe sot e në të ardhmen ne kemi nevojë për institucione që kanë forcë e legjitimitet



të ndikojnë në parandalimin e krizave apo në zgjidhjen e tyre. Mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë institucioni i Presidentit të Republikës është i vetmi institucion që mund ta përmbushë këtë rol specifik në hierarkinë e institucioneve kushtetuese

dhe politike. Për ta mundësuar këtë, vetë Presidenti ka nevojë për mandat më të gjerë sesa mazhoranca e një partie apo koalicioni politik, ka nevojë për testim dhe mbështetje publike", vijon letra e ish presidentëve drejtuar Kuvendit.

NDRYSHIMET E 2008-ËS

Referuar ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2008-ë, Topi, Moisiu e Meidani theksojnë se ato prodhuan një sistem përfaqësues politik të cunguar, ndërsa Kuvendin aktualisht nuk reflekton sovranitetin e popullit, siç kërkohet nga Kushtetuta. "Bindja jonë është se ndryshimet kushtetuese (2008) lidhur me zgjedhjen e presidentit të Republikës, me sistemin zgjedhor, si dhe ndryshimet e vazhdueshme në institucione të veçanta të



Alfred Moisiu, Bamir Topi dhe Rexhep Meidani

drejtësisë, kanë rezultuar jo efikase dhe problematika për cilësinë e sistemit qeverisës në vend. Bazuar në përvojat tona dhe në analizën e funksionimit të sistemit përfaqësues në Shqipëri, ne ju adresojmë përmes këtij komunikimi, tre probleme, të cilat, vlerësojmë se janë me rëndësi parësore në stadin aktual të vendimmarrjes dhe të ecurisë së procesit demokratik në Shqipëri", thuhet në letër.

"DREJTËSIA"

Reforma në drejtësi në gjykimin e ish presidentëve,

është dhe mbetet jetike dhe se ajo duhet të realizohet pa humbur kohë. "Reforma në drejtësi është mbi të gjitha në dobi të vendit, të reformave, të procesit integres, të qytetarëve, të cilësia së demokracisë dhe në fund mund edhe të jetë një çështje me interes pragmatist të partive të aktuara politike. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet pranuar që ky interes i fundit të bëhet dominues dhe të mbajë peng vendimmarrjen e nevojshme për reformën në drejtësi", thuhet në letër.

DENIS MINGA
TIRANE

Deputeti i Partisë Demokratike, Kastriot Islami, u shpreh në "45 minuta" nga Denis Minga në Report Tv, se reforma në sistemin e drejtësisë do të prekë edhe dekriminalizimin e Mediave. Islami foli për manjatë të mediave në parlament të cilët sipas tij janë pasuruar falë lidhjeve me politikanë të korruptuar. Objekt i Byrosë Kombëtare të Hetimit, tha ai, do të jetë pikërisht edhe kjo kategori. Duke folur për reformën në drejtësi, Islami tha se Partia Demokratike është dakord në parim me draftin e ekspertëve, por ka kërkuar kohë për ta lexuar projektin e tyre. I pyetur nëse do të jetë sërish kandidat për deputet në radhët e demokratëve, Kastriot Islami tha se do të jetë në politikë, pavarësisht vendimit të Partisë Demokratike.

Z. Islami, kryefjalë e aktualitetit politik është sërish reforma në drejtësi. Është një draft i amerikanëve, thuajse gati, PS dhe LSI kanë dhënë "Ok", PD sikur ka një lloj hezitimi...

Ka dy elementë. I pari, PD dhe opozita në tërësi është shprehur se kërkon një reformë për një sistem gjyqësor të paanshëm që nuk kapet nga politika, profesionit dhe tjetra që shpesh koorporativizmin. Për fatin e mirë të opozitës, pasi procesi ka qenë i njëanshëm, Komisioni i Venecias, ka dhënë rekomandime të cilat janë në përputhje të plotë me qëndrimet e opozitës. Opozita ka kërkuar konsensus dhe respektimin e parimeve të Venecias. Momenti i dytë është se Rama kontrollon mediat dhe ka përhapur idenë se opozita nuk e do reformën. Opozita ka qenë në pararojë të kësaj reforme, e ka kërkuar dhe është gati të miratojë reformën, por duke parasysh një proces që duhet zhvilluar, procesi është ky: kanë bërë tavolinë politike, kanë rënë dakord për një serë pikash dhe ekspertët e OPDAT e EURALIUS kanë përgatitur një draft. Do të diskutohet drafti, do të bëhen pyetje përgjigjet e etj.

Zoti Majko tha të votohet në parim...

Zoti Majko është qesharak. Tha në komision ta miratojmë pa e lexuar. Unë s'jam qesharak e banal. Duhet ta lexoj materialin. Pasi ta kem lexuar, do të kem pyetje. Në parim jam dakord që të bëhet reforma. Do të jem në ballë të reformës, për një reformë me parime. Reforma do të miratohet në parim, nën parim. Reforma ka pjesën e Byrosë së Hetimit, që duhet të dimë se në Amerikë FBI godet presidentin në detyrë dhe ministrat në detyrë, sepse ata e kanë pushtetin dhe ata nuk e lejojnë gjyqësorin të hetojë. Duke u bërë pjesë e reformës, kjo reformë e ndihmon opozitën për të luftuar atë korruption që po ndodh tani. Prandaj, PD kanë kërkuar që të bëhet FBI e para. Rama ka frikë për këtë,



Kastriot Islami në emisionin "45 minuta" nga Denis Minga në Report Tv

"Reforma në drejtësi prek edhe dekriminalizimin e mediave"

Islami: "Do të mbetem në politikë edhe po s'më kandidoi i Partise Demokratike"

po t'i thuash që do hetojë ministrat e kryeministrin në detyrë. Pjesa e dytë janë institucionet e drejtësisë. Do të diskutohet nën parim. Pastaj do të vijë puna e implementimit, ku do të ketë akte nënligjore. Do të ketë edhe një kalendar veprimesh ku e para do të jetë Byroja dhe institucionet. Opozita është e interesuar që Byroja, e cila ka disa detyra, për të dhënë drejtësi për dekriminalizimin, pasi vetëm një Byro Hetimore e fuqishme mund ta bëjë. Ka një raport të OSBE-së dhe aty ka një numër, në krye të saj është Edi Rama që akuzohet për 200 mln euro pasuri. Nëse ky sistem drejtësie nuk do të hetojë, investigojë e të japë drejtësi për këtë, atëherë ky sistem drejtësie nuk do të funksionojë. Jo për ta futur në burg, por për të hetuar e për të dhënë drejtësi.

Reforma thotë që të gjithë do të kalojnë në sitë...

Problemi është aktual. Nëse nuk ushtrohet aktuali, kjo reformë nuk krijon besim. Ka një raport të OSBE, për 200 milionë euro pasuri të kryeministrit. Dhe ky raport, pavarësisht se ku u kalua lehtë duke tentuar t'i bëjnë presion ambasadorit të OSBE, është në duart e të gjithë zyrtarëve nënkombëtarë.

Ju keni qenë djenë seancë dhe e ndoqët kryeministrin aktual që i thoshte Berishës, hajde votoje reformën. Pse nuk po përshpejton etapën PD?

Rama është mjeshtër i mashtrimeve. Ka edhe një media të tërë që mashtron. Këtu nuk jemi dy fshatarë që i bëjnë presione njëri-tjetrit. I vetmi person që ka frikë nga një FBI e pavarur, është Edi Rama. Dhe luan bllofin.

Z. Berisha nuk ka frikë?

Supozojmë se Berisha ka frikë. Edhe po ta kundërshtojë PD kjo reformë do të bëhet. PD nuk e refuzon, por edhe sikur ta refuzojë PD, ajo do të bëhet. Është lojë e mashtrimeve të Ramës. I vetmi person që ka frikë, është ai në detyrë. Ky është qëllimi i kësaj reforme.

Si mund të kalojë reforma pa PD?

Kjo reformë nuk po bëhet se do apo s'do Rama. Rama në thelb nuk do, sepse kjo reformë do të quhet sukses nëse do të marrë nën hetim Ramën. Shtëpia e tij, që thotë 300 mijë euro, por kushton edhe më shumë, dhe pasuria 200 mln euro, po nuk u hetuan, kjo reformë nuk është asgjë, reforma

është e dështuar. Këtë reformë e duan SHBA dhe BE, BE do që Shqipëria të futet në standarde, siç u futën vendet si Bullgaria dhe Rumania.

PD do të kërkojë sërish kohë, pas të hënës?

PD do ta miratojë këtë reformë në çdo rast. Edhe për draftin në parim është dakord, por do ta lexojë dhe do të bëjë pyetje e sqarime, kur të bëhet debati nën parim dhe kalendarit të implementimit të saj. PD kërkon që kjo të mos lihet 9 muaj afër zgjedhjeve, sepse Rama mund të shpallë goditjen e ministrave për korruption, të të inkriminoarve, rasteve të korruptionit, koncesioneve.

Si mund të bëhet dekriminalizimi i medias?

Byroja e Hetimit duhet të merret edhe me ata manjatë që janë futur në parlament. Janë biznesmenë që kanë përfituar nga politikanët e korruptuar. Të gjithë këta që janë biznesmenë futur në parlament pasi kanë bërë para. Ka manjatë të medias jashtë dhe brenda parlamentit. Duan të futen brenda te tava e Ramës. Nuk është sekret. Kryeministri i jugut, Koço Kokëdhima është një nga këta. Në raportin e OSBE është thënë për lidhjet e tij me biznesin rus. Është një nga simbolet. Janë të gjithë ata që kanë qenë drejtor të Tatimeve, Doganave etj. E në fund janë ata me rekorde kriminale. Këta do të kalojnë në sitën e FBI.

Kur mendon PD për miratimin e reformës?

Për tre muaj po të jetë e mundur që në shtator FBI të nisë punën. Rama e ka vonuar, stërvonuar reformën dhe në fund fare thotë kot e keni bërë se, ky

është një vendim kot. Rama vazhdon ta shmangë sërish. Një gjë tjetër që duhet të merret FBI është të verifikojë nëse e kanë plotësuar të gjithë deputetët formularin e vetë deklaratimit apo jo. Me këtë duhet të merret FBI. PS dhe Rama vranë 15 profesorët dhe i zëvendësuan me kriminelë e vrasës. Është hera e parë që kemi një PS dhe një Rilindje. Një PS që jep votat dhe një Rilindje që merr pushtetin.

Z. Berisha ka rihapur së fundi një ngjarje, atë të 98-ës dhe ka thënë se mund ta bëjë sërish me 5000 veta... ju keni qenë në krahun tjetër atëherë...

Berishën e kam patur kundërshtar dhe loja e kundërshtarëve ka patur edhe probleme të tjera. Unë jam vrarë nga Edi Rama, profesor doktor i eliminuar nga Edi Rama. Jam hedhur në humnerë nga Edi Rama. Rama ka bërë thirrje madje mos e shpëtoni dhe në këtë kohë ka ardhur z. Berisha me një propozim, "do të vish nga ne". Berisha ka qenë kundërshtari im, siç kemi bërë ne gabime në luftën me kundërshtarë, ka bërë edhe Berisha. Kurse Rama ka vrarë 15 profesorë brenda. Po vret edhe Mimoza Hafizin. Pse? Sepse kërkon të marrë pushtetin dhe të fusë kriminelët.

Cili është koment juaj për deklaratat e Berishës për armët dhe ngjarjet e 98-ës. Pranoi se ka hapur depot e armëve, pranoi se ka qenë aktor në 98-ën...

Berisha ka thënë se në momentin që shteti bashkohet me kriminelin dhe vret opozitën, ka vetëm një mënyrë për tu mbrojtur, të armatoset populli me ligj. Pastaj ka rimmarrë 98-ën. Unë në atë kohë kam patur vlerësime të tjera, natyrisht. Berisha ka një vlerësim se shteti në atë kohë kishte lidhje me kriminelin.

E keni quajtur grusht shteti në atë kohë, po sot e quani të tillë?

PS e quajti grusht shtetit. Fillimisht u quajti grusht shteti, pastaj u hoq dorë me radhë. Më pas u futën nënkombëtarët dhe u spostuan nga ai qëndrim. Unë jam akoma i ri për të bërë histori dhe mundohem të vlerësoj me qetësi përplasjet e asaj kohe. Lideri i dhjetorit u vra në atë kohë nga njëri që ishin policë, me pushtet. PD bënte lidhjen se ky ishte shteti që vrau liderin e dhjetorit. Vetë Berisha pat thënë se vrasësi është Fatos Nano, pastaj tha jo.

Në vitin 2017-ë, ku do të jetë Islami?

Islami që nga dita parë që është angazhuar punon 14 orë në politikë.

Sa orë punoni për PD?

14 orë punoj për PD, për opozitën, për të mirën e vendit dhe kundër të këqijave. Nuk largohem nga politika, jam apo s'jam deputet pa e shkatërruar këtë të keqe.

Z. Basha tha se askush nuk e ka të sigurt vendin e deputetit...

Shumë mirë ka bërë që e ka thënë. Unë do vazhdoj të punoj.

INTERPELANCA


Në Kuvend është depozituar një interpelancë, me kërkesë të Idrizit, i cili kërkon një përballje me Edmond Haxhinastos dhe Mesila Dodës

SPAHIU

Deputeti i LSI-së në Qarkun Dibër, Përparim Spahiui ka kërkuar pak kohë më parë ka kërkuar një seancë pyetje me Arben Ahmetajn dhe atë të Transporteve, Edmond Haxhinasto për punimet e vonuara në Rugën e Arbrit.

ESIONA KONOMI
TIRANE

Tëksa partitë politike kanë ndezur të gjitha motorët e riorganizimit në prag të kësaj fushate elektorale, PDIU ka nisur fuqishëm fushatën në qarkun e Dibrës. Duket se kjo do të jetë zona elektorale që do t'i besohet deputetes më të re, po edhe më të promovuar brenda kësaj partie, Mesila Doda. Kjo konfirmohet nga disa lëvizje politike të Shpëtim Idrizit, i cili ka fuqizuar Dodën në krye të grupit parlamentar, e po ashtu i ka besuar sipërmarrje të fuqishme politike, duke e bërë zërin më përfaqësues edhe në debatin publik sa i takon kësaj partie. Pas një takimi elektorale në Dibër, ku Doda ka edhe origjinën e hershme, ajo ishte protagoniste. Nga ajo ditë, bërja e Rugës së Arbrit, u kthye thjeshtë në motiv të kësaj partie, duke bërë shkrime në disa media për këtë çështje, e disa herë duke replikuar përmes medias, me deputetin e Dibrës nga krahu i LSI-së, Përparim Spahiui. Ky i fundit, po ashtu, kohë përpara takimit të PDIU-së në Dibër, i kishte kërkuar qeverisë në disa raste mbajtjen e premtimit për këtë rrugë. Por ditën e djeshme, në Kuvend është depozituar një interpelancë, me kërkesë të Shpëtim Idrizit, i cili i kërkon Metës një përballje për këtë rrugë me Edmond Haxhinastos, dhe Mesila Dodës. Ky faktorizim pritet të rritë kredibilitetin e kësaj deputeteje në këtë zonë. "Në mbështetje të nenit 96 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, paraqesim kërkesën tonë për interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, në lidhje me



Mesila Doda

PDIU i "lëshohet" Rugës së Arbrit, replikë me LSI-në

Shpëtim Idrizi piketon Dodën si kandidate në Dibër, kërkon interpelancë me Haxhinaston

ecurinë e punës në Rugën e Arbrit. Duke e konsideruar me rëndësi të jashtëzakonshme që ka ky projekt për Dibrën dhe gjithë zhvillimin e zonës verilindore, për fuqizimin ekonomik dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare e njerëzore me të gjithë trevat e tjera të Shqipërisë; duke nënvizuar rolin tejet të rëndësishëm që ka ky projekt për përafrimin e shqiptarëve me banim në Maqedoni me shtetin amë dhe detyrimin kushtetues që ka shtetit shqiptar për përkujdesin ndaj tyre, kërkojmë të merren masa për zhvillimin e një interpelance sa më shpejt të jetë e mundur"-thuhet në kërkesën e Idrizit. Po ashtu, kërkohej që interpelanca të përqendrohet në dhënien e informacionit për disa



pyetje rreth këtij investimi. "A do ta ndërtoni Rugën e Arbrit? A do ta ndërtoni brenda këtij mandati Rugën e Arbrit? Sa fonde janë dhënë deri më tani për këtë rrugë dhe si është zgjidhur çështja e financimit të saj? Ku ka ngjitur realizimi i këtij procesi dhe si është menduar të zgjidhet? Sa është dëmi që pësojnë banorët e zonës për mos përfundimin e infrastrukturës? Sa do e shkurtonte distancën e sotme ndërtimi i Rugës së Arbrit? Edhe sa kohë do të duhet për të përfunduar Ruga e Arbrit? Ku jeni me premtimet e fushatës elektorale dhe programin e qeverisë lidhur me këtë çështje? Interpelanca do të zhvillohet nga deputetja, Mesila Doda"-përfundon letra e Idrizit.

IRONIZON BOÇI

Thoma Gëllçi zgjidhet drejtor i radiotelevizionit publik shqiptar



Thoma Gëllçi

Radio Televizioni Publik Shqiptar tashmë ka një drejtor të ri. Thoma Gëllçi u zgjodh këtë të premtë drejtor i përgjithshëm i RTSH-së, duke zëvendësuar kështu Martin Lekën. Këshilli Drejtues i RTSH-së, organi që zgjedh drejtorin, dha 7 vota pro kandidaturës së gazetarit Thoma Gëllçi dhe 4 kundër, nga 11 anëtarë që ka në përbërje. Gëllçi kandidonte në këtë post me profesor Petrit Malajn. Pas lajmit për zgjedhjen e Thoma Gëllçit drejtor i RTSH ka ardhur edhe reagimi i deputetit të PD Luciano Boçit i cili ironizon këtë vendim. Me anë të një statusi në rrjetin social Facebook, Boçi shkruan se Gëllçi është ish kryeredaktor i gazetës "Zëri i Popullit" dhe me ironi thotë se tashmë u bind që RTSH do ti kthehet "populli" "RTSH i KTHEHET "POPULLIT"!!!!??? Lajmi i fundit: Thoma Gëllçi, ish kryeredaktor i "Zërit të popullit", pas ndryshimit të ligjit që tani e tutje mund të quhet fare mirë Ligji "Gëllçi" dhe jo Ligji për mediat audiovizive", u zgjodh "drejtor me shumicë të cilësuar (7 me 4). Tejkalo dhe ndryshimin ligjor që u bë me agjersë e mund!!! Pas kësaj "u binda" se RTSH vërtet do "t'i kthehet" "publikut"!!!! Madje me shumë se kaq: Do "t'i kthehet" popullit!!!!!! Ka mundësi ta emërtojnë dhe "RTSH-Zëri i popullit". E hajde e thoni tani po të doni që në Shqipëri media nuk është e lirë!!!!"-shpreh Boçi.

FATMIR MEDIU/ REFORMA ZGJEDHORE ËSHTË DETYRA KRYESORE E OPOZITËS

"E djathta s'duhet të anashkalojë Reformën"

Kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu ka thënë dje se e djathta në Shqipëri nuk duhet të anashkalojë çështjen e Reformës Zgjedhore. Këtë deklaratë ai e ka bërë gjatë një takimi me të gjithë drejtuesit e qarqeve dhe degëve në rrethe të PR-së ku theksoi se e djathta duhet patjetër të ketë qëllime të kristalizuara mbi objektivat e Reformës Zgjedhore, si implementimi i listave të hapura, identifikimi, numërimi dhe votimi elektronik, financimi i fushatës elektorale nga buxheti i shtetit, çka do të sjellin një garë të ndershme dhe do të zhveshin Kuvendin e Shqipërisë, nga sistemi korruptiv dhe i pazareve me

përfaqësuesit e qytetarëve. Duke nënvizuar rëndësinë e zgjedhjeve të ardhshme, jo si një shpresë për të rikthyer të djathtën në pushtet, por si e vetmja rrugë për të nxjerrë Shqipërinë dhe shqiptarët nga kolapsi, kryetari republikan u shpreh se "duhet patjetër një qëndrim i unifikuar i së djathtës dhe i opozitës në tërësi, bashkë me qytetarët, duke konkretizuar aksionin politik si në Reformën në Drejtësi, ashtu edhe në atë Zgjedhore". Duke e vlerësuar Reformën në Drejtësi, si hap themelor për rikthimin e shtetit brenda kuadrit ligjor, Mediu nënvizoi se e djathta nuk duhet të anashkalojë, madje të ketë prioritet

të saj, Reformën Zgjedhore. "Reforma Zgjedhore dhe garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, është detyra kryesore e opozitës". Mediu, u ndal në një analizë mbi qeverisjen Rama-Meta, duke e cilësuar si më të keqen dhe më të paafatën në 25 vitet e fundit. "Korrupsioni i ulur këmbëkryq në të gjitha institucionet shtetërore, ekonomia në rënie pikatë me koncesione abuzive dhe investitorë të huaj që largohen çdo ditë; shifrat e larta të kriminalitetit që nuk po njeh asnjë pengesë, por përkundrazi, si dhe shpresa e vvarë e shqiptarëve që po tentojnë të braktisin çdo ditë Shqipërinë" tha ai.

GJENDJA
"Korrupsioni i ulur këmbëkryq në të gjitha institucionet shtetërore, ekonomia në rënie pikatë me koncesione abuzive dhe investitorë të huaj që largohen çdo ditë



Fatmir Mediu

Ksera dhe Bitro në gjyq për vjedhjen e 30 mln lekëve

Prokuroria e Tiranës mbyll hetimet për 7 persona për vjedhje me tenderat fiktivë

ELTON QYNO
TIRANË

Në një kohë kur ka humbur të gjitha betejat ligjore me drejtësinë për të dalë nga qelia, ish-ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale Spiro Ksera, e ka parë veten të pandehur së bashku me 6 persona të tjerë. Ksera është vënë nën akuzë për "Vjedhje duke shpërdoruar detyrën" dhe se dosja në ngarkim të tij është transferuar në gjykatën e Tiranës në pritje për tu gjykuar. Ka qenë prokurori Ndini Tavani që ka depozituar në gjykatë kërkesën për hapjen e procesit gjyqësor ndaj ish-ministrit Ksera dhe 6 bashkëpunëtorëve të tij mes tyre ish-sekretari i përgjithshëm i ministrisë Kleves Bitro dhe ish zyrtarë të tjerë shtetërorë. Me të pandehurve është dhe Alban Karabashi administrator i kompanisë së eventeve "Karabashi". E konsideruar si dosja "Ksera" veprimet e paligjshme të zyrtarëve i shkaktojnë shtetit një dëm prej 30 milion lekë me anë të vjedhjes dhe falsifikimit të dokumenteve. Së bashku me Kserën nën akuzë janë dhe 4 ish-vartës të tij dhe administratori i një kompanie private, ku në bashkëpunim me njëri-tjetrin sipas prokurorit Tavani ata krijuan dokumente fiktive për aktivitetet të realizuara më parë. Këto para u morën nga Buxheti i shtetit por vetë Ksera i cili kërkoi lirinë në të gjitha shkallët e gjyqësorit mohoi akuzën duke e cilësuar atë si



Kleves Bitro dhe Spiro Ksera

të motivuar politikisht pasi ai është përfaqësues i minoritetit Grek në vendin tonë.

DOSJA NR.2

Ish-ministri i Punës Spiro Ksera që prej pesë muajsh ndodhet në qeli për 6 abuzime me aktivitetet e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, ndodhet nën hetim

nga njësia hetimore Task-Forcë dhe për një çështje tjetër, shumë të ndjeshme jo vetëm për Shqipërinë por edhe për SHBA. "Shqiptarja.com" mëson se ndaj Kserës prokuroria ka një hetim të dytë, që bën fjalë për abuzimet me miratimin e vizave amerikane për "zyrtarët" e ministrisë që dikur drejtohej

nga Ksera. Burimet pranë prokurorisë thanë se Ksera, në periudhën kur tre shtetas nga Elbasani, dy femra dhe një burrë janë larguar në Amerikë, duke u maskuar si punonjës të Ministrisë së Punës, ka drejtuar këtë dikaster si dhe ka firmosur për marrjen në punë të tre individëve, të cilët disa kohë më parë janë

Fondet Dy fotot e falsifikuara të aktiviteteve të ministrisë

Prokuroria e Tiranës ka zbuluar një nga rastet flagrante të vjedhjes së fondeve me anë të manipulimit të fotove të aktiviteteve sociale në Ministrinë e drejtuar nga Spiro Ksera. Ndër provat e Prokurorisë kundër ish-ministrit të Punës Spiro Ksera, akuzuar për vjedhje duke shpërdoruar detyrën, janë dy foto, njëra është origjinale dhe tjetra e falsifikuar nga punonjësit e Kserës. Sipas organit të akuzës ministria ka manipuluar me "Photoshop" fotot e një aktiviteti të zhvilluar nga PNUD në Shqipëri, duke e shtur si foto të një aktiviteti të zhvilluar nga ministria, për të cilin është marrë edhe fond, por që nuk është zhvilluar kurrë. Pra ministria mjaftohej vetëm me një foto të përpunuar për të justifikuar paratë që merrte nga buxheti i shtetit për zhvillimin e aktiviteteve me rëndësi sociale për komunitete të ndryshme në vendin tonë.

TË PANDEHURIT

- Spiro Ksera ish-ministër
- Kleves Bitro Ish-sekretari i ministrisë
- Artevis Mene
- Dritan Fejzulla
- Elda Kozaj
- Elisabeta Dodbiba
- Alban Karabashi administrator i Agjencisë "Spektakël Karabashi"

kapur në SHBA, me dokumenta të parregullta. Për këtë çështje ka qenë nën hetim dhe ish-sekretari i Përgjithshëm i kësaj ministrie, Kleves Bitro, i cili tashmë është dënuar për këtë krim. Ndërkohë hetimet janë ende të hapura për ish-ministrin Ksera dhe disa persona të tjerë. Këto hetime kanë nisur pas kallëzimit të bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ambasada Amerikane.

PËRGJIGJIA NGAMERIKA

Tashmë hetimi po verifikohet me shumë intësi nga prokurorët e njësive hetimore Task-Forcë, të cilët janë në pritje të letërposisë nga SHBA, ku nga përkërgjigia e së cilës do zbardhet e plotë mënyra e veprimit të ish-zyrtarëve të ministrisë së Punës. Deri në këtë fazë ku ndodhet hetimi mësohet se në prokurori nuk ka mbëritur asnjë përgjigje nga SHBA.

"HACKER"/ I DËRGOI FOTOT NUDO TË DASHURIT, AUTORËT I KËRKOJNË 300 MIJË LEK

Nxënësja shantazhohet me foto nudo, arrestohen tre të rinj

Një nxënëse e një gjimnazi në Tiranë me iniciale E.P është gjëbitor me 300 mijë lek të vjetra nga tre të rinj, të cilët e kërcënonin se nëse nuk paguante lekët do i publikonin në internet disa foto nudo, që ata kishin mundur ti siguronin nëpërmjet vjedhjes së pasërdit të "FB". E vënë nën tryshninë e publikimit të fotove nudo, të cilat nxënësja ja kishte dërguar në FB të dashurit të saj që jetonte në Itali, adoleshentja ka vendosur ti drejtohet policisë së Tiranës në 25 mars 2016, duke depozituar kallëzim penal. Në deklarimin e saj para oficerëve të policisë adoleshentja ka rëfyer se adresa e saj është sulmuar nga persona të panjohur duke i thyer kodin e sigurisë dhe prej profilin të saj kanë marrë disa foto nudo që ajo ia ka dërguar të dashurit të saj që kishte udhëtuar në Itali. Më tej E.P ka shtuas se me anën e këtyre fotove një person i panjohur e ka shantazhuar duke i kërkuar 300 mijë lek të vjetra, pasi në të kundërt fotografitë do ja

publikonin në internet. Lidhur me këtë çështje hetime ka kryer dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku pas një javë hetime është mundësuar identifikimi i autorëve të kësaj gjobëvënie. Më konkretisht bëhet fjalë për 19-vjeçarin Sokol Kraja dhe dy shokët e tij të mitur E.S dhe A.B. Për dy

të miturit gjykata e krimeve të rënda ka caktuar masën e sigurisë në mungesë detyrim paraqitje ndërkohë për Sokol Krajin është vendosur masa e arrestit në burg. Pas këtij vendimi, ditën e djeshme policia arrestoi të tre personat, duke organizuar operacionin "Hacker". Mësohet se gjatë




marrjes në pyetje, Sokol Kraja ka pranuar autorësinë e krimit duke pohuar se ka qenë ai personi që ka shantazhuar me fotot e saj nudo, vajzën e mitur për ti dhënë shumën e parave prej 300 mijë lekë. Kraja ka treguar, se pasërdit i profilin të FB të vajzës është marrë në një qendër inter-

neti nga një shoku i tij E.S, i cili së bashku me A.B, kanë ndjekur në distancë të afërt komunikimin e vajzës me të dashurin e saj në Itali. Pas vjedhjes së pasërdit, të rinjtë kanë hyrë në profil dhe kanë marrë fotot, duke filluar me pas shantazhet për dhënie të shumës prej 300 mijë lekë.

LEZHË/ DËNOHET ME 5.6 VITE BURG KRYEKOMISIONERI I DAJÇIT

Gjykata jep vendimin për çështjen e 6 komisionerëve



Gjykata e Lezhës ka dhënë vendimin e saj për 6 komisionerët e Dajçit në zgjedhjet vendore të vitit 2011 të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin falsifikuan dokumentet zgjedhore me qëllim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve. Burg për kryetarët, nënkryetarët dhe sekretarët e qendrave së votimit dhe gjopa për anëtarët e tjerë të komisionit. Ky ishte vendimi i gjykatës së Lezhës për komisionerët e qendrave të votimit 0697 Dajç dhe 0700 Kotër në zgjedhjet e 8 Majit 2011 për

Komunën Dajç të Lezhës. Në total Gjykata e Lezhës dënoi me 5 vite e 6 muaj burg drejtuesit e qendrave të votimit, ndërsa anëtarët e tjerë të komisionit do të jenë të detyruar të paguajnë nga 100 mijë lekë të reja secili. Vendimi i dhënë nga gjykata si Jak Ndoka për 16 komisionerët është 5 herë më i ulët nga çfarë kishte kërkuar në pretendencë e tij organi i akuzës. Por prokurori i çështjes që kishte kërkuar 28 vite burg në total për të pandehurit nuk e kundërshtoi atë si dhe pretendoi dërgimin e çështjes në apel. Këtë gjë

në fakt do ta bëjnë komisionerët e dënuar me burg, të cilët nëpërmjet avokatit të tyre e kanë cilësuar dënimin si të padrejtë. Komisionarët e qendrave të votimit në ish-komunën e Dajçit në Lezhë u akuzuan për falsifikim dokumentesh dhe shpërdorim detyre duke ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Denoncimi ishte bërë nga ish-kandidati për kryetar të komunës Dajç në Lezhë në zgjedhjet e 8 Majit 2011, që me vendimet e gjykatës konfirmohet edhe falsifikimi i rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Prokuroria sekuestro mbi llogaritë bankare të Makashit

Mashtrimet për viza në Kanada, Australi dhe Angli, emrat e që kanë bërë kallëzim

ELTON QYNO
TIRANË

Llogaritë bankare të agjencisë së punësimit Ande-Lm, administratore Lule Makashi dhe të bijës Adeila Makashi janë vendosur nën sekuestro për llogari të hetimeve të Prokurorisë së Tiranës. Lule Makashi u prangos pak ditë më parë teksa u deportua nga Kanadaja së bashku me të bijën Adeila ndërsa qëndron me masën e sigurisë arrest me burg për akuzën e mashtrimit me pasojë të mëdha. Nga parashtrimi i prokurorit në seancë gjyqësore rezultoi se prokuroria më datë 26 prill 2016, ka regjistruar procedimin penal nr.3534.për veprën penale të "Mashtrimit" me pasojë të rënda, në ngarkim të shtetas Adeila Makashi, Lule Makashi dhe Klevis Rreshka. Nga veprimet hetimore të kryera nga prokuroria ka rezultuar se në 25 maj 2016 në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë janë paraqitur dhe kanë bërë kallëzim 26 shtetas. Këta shtetas në kallëzimin e tyre kanë shpjeguar se kanë aplikuar në vitin 2014, për punësim dhe studime pranë shoqërisë "Ande-LM" Sh.P.K me administratore shtetasen Luli Makashi që ndodhet me seli në rrugën "Ismail Qemali" Tiranë që të pajiseshin me viza studimi apo punësimi në Kanada, Angli, Australi etj. Pas kontaktit që këta shtetas merrnin me shtetasen Luli Makashi ajo ju premtojte se shumë shpejt do të pajiseshin me vizë, dhe për këtë fakt të kryenin pagesat në bankë, për llogari të firmës ANDE-LM shpk. Shtetasit që kanë aplikuar dhe kanë dorëzuar dokumentat për pajisjen me vizë, kanë paguar në llogari të



Lule Makashi

shoqërisë "Ande-LM" Sh.P.K, shuma të konsiderueshme në lekë dhe valutë, në banka të ndryshme që operojnë në territorin Shqiptar. Pasi kanë shkruar në datë 25 prill 2016 pranë zyrrave të kësaj shoqërie kanë mësuar se shtetasja Luli Makashi së bashku me vajzën e saj Adeila

Makashi ishin larguar jashtë shtetit, dhe se në administrim këtë shoqëri i'a kishin lënë shtetasit Klevis Rreshka i cili është prezantuar se e kishte blerë ai këtë shoqëri dhe do i ndiqte ai procedurat për aplikantët që kishin bërë aplikimin dhe për personat që do të aplikojnë. Nga vepr-

Pagesat

Shtetasit që kanë aplikuar dhe kanë dorëzuar dokumentat për pajisjen me vizë, kanë paguar në llogari të shoqërisë "Ande-LM" Sh.P.K, shuma të konsiderueshme në lekë dhe valutë, në banka të ndryshme që operojnë në territorin Shqiptar.



Viza studimi

Për punësim dhe studime pranë shoqërisë "Ande-LM" Sh.P.K me administratore shtetasen Luli Makashi që ndodhet me seli në rrugën "Ismail Qemali" Tiranë që të pajiseshin me viza studimi apo punësimi në Kanada, Angli, Australi etj.



KALLËZIMI PENAL

- 1. Edmir Jahja
- 2. Manjola Kotarja
- 3. Floridian Memlikaj
- 4. Ardian Demirrari
- 5. Bledi Loli
- 6. Lorenc Lorja
- 7. Taulant Ailanj
- 8. Aleksandër Shtjefni
- 9. Petrit Vukaj
- 10. Damian Mhilli
- 11. Gerlinda Pevaci
- 12. Gentian Shpati
- 13. Majlinda Milo
- 14. Dritan Troque
- 15. Fatmir Llenga
- 16. Paulin Hila
- 17. Astrit Zaganjori
- 18. Dhimitraq Andrea
- 19. Shahin Hysi
- 20. Shkelqim Qose
- 21. Ledina Celibashi
- 22. Bledar Basha
- 23. Klebeta Demiri
- 24. Sokol Zerani
- 25. Mateo Asllanaj
- 26. Besjana Ismailianji

rimet hetimore të kryera nga prokuroria ka rezultuar se shtetasja Luli Makashi është administratore dhe ortak e vetme e shoqërisë "Ande-LM" shpk me status aktiv. Nisur nga sa më lart, duke qenë se shumtë e paguara në banka të ndryshme për llogari të shoqërisë dyshohet se janë pasuri e përfutur nga kryerja e veprës penale të dyshuar, produkt i saj, si dhe ka rezik që disponimi i lirë i kësaj pasurie mund të rëndojë se të zgjasë pasojat e veprës si dhe lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, është e domosdoshme që të kryhet sekuestroja preventive mbi llogaritë bankare dhe ambjentet e kësaj kompanie.

LAJME

shkurt



Kapen me drogë, përleshen me policinë, ai e qëllon me armë

Dy persona kanë rënë në prangat e policisë së Fierit, pasi iu është gjetur e sekuestruar 7.2 kilogram lëndë narkotike kanabis sativa, ndërkohë që njëri prej tyre ka plagosur me mjet prerës, thikë, një punonjës policie gjatë arrestimit çka ka sjellë edhe reagimin e këtij të fundit që e ka qëlluar atë me armën e shërbimit. Droga është sekuestruar në sajë të operacionit të koduar "STREET" ku në flagrancë u kapën Agron Xhaxhaj, 27 vjeç dhe Ergent Braçe, 28 vjeç. Lënda narkotike iu është gjetur në një banesë në Roskovec dhe gjatë momentit të arrestimit, Agron Xhaxhaj ka kundërshtuar me dhunë policinë.



Zbulohet sera me 20 000 bimë kanabis, arrestohet i moshuari

Efektivat e Komisarariatit të Policisë Krujë kanë finalizuar me sukses operacioni i koduar "Arameras", ku është asgjësuar një serë me 20 000 bimë narkotike të llojit Cannabis Sativa. Gjatë këtij operacioni është bërë i mundur arrestimi në flagrancë i 65 vjeçarit, Vesel Sala, banues në Krujë. Arrestimi i tij u bë pasi gjatë kontrollit të ushtruar në serat e tij, në fshatin Aramera, Krujë, iu gjetën dhe iu asgjësuan me anë të djegies rreth 20 000 bimë narkotike të dyshuara të llojit Cannabis Sativa. Gjithashtu, u shpall në kërkim dhe po punohet për kapjen e djalit të tij, A.Sala 40 vjeç, banues në Arameras.

ITALI / HISTORIA E TMERRSHME KA NDODHUR NË JESI TË ANKONËS

Babai shqiptar prej 10 vitesh e përdhunonte vajzën

Një shqiptar në Itali ka tronditur opinionin publik për shkak të një historie rrëqethëse që mbart mbi vete. Prej 10 vitesh ai përdhunonte sistematikisht vajzën e tij e për të mos mjaftuar vetëm kaq, babai e dhunonte vajzën duke e qëlluar me shkelma në bark në mënyrë që ajo të mos mbetej shtatzënë. Historia e tmerrshme ka ndodhur në Jesi të Ankonës. Babai shqiptar i moshës 45 vjeç, emri i të cilit nuk bëhet i ditur nga mediat italiane, është duke u gjykuar për këtë krim makabër ndaj fëmijës së tij, vetëm 8 vjeç në kohën kur është bërë për herë të parë viktimë e dhunës seksuale nga babai. Vajza, e cila është në gjendje mjaft të rënduar psikologjike, tashmë është 23 vjeç

dhe studion. Gjykimi ndaj tij vijon prej 6 muajsh kohë gjatë së cilës babai është në paraburgim, e shumë shpejt pritet të dalë në gjyq për tu njohur me vendimin e drejtësisë italiane. Sipas mediave italiane, kërcënimet ndaj vajzës kanë qenë të shumta: Nëse flet do të shfaros të gjithë familjen, -i thoshte vajzës "Po the gjë, do vrasim në fillim mamanë tënde, pastaj motrën, vëllain dhe në fund unë do të vras veten duke të lënë vetëm në këtë botë", mësohet t'i ketë thënë i ati të miturës. Abuzimi daton në fillim të viteve 2000, kohë në të cilën e gjithë familja shkoi në Itali të bashkohej me kryefamiljarin, i cili kishte shkruar të punonte më parë në shtetin fqinj. Vajza është duke u mbrojtur nga avokatja Marina

Magistrelli, para së cilës ka gjetur guximin të rrëfejë disa nga veprimet e dhunshme të babait të saj. Sipas dëshmisë, ai e përdhunonte një herë në dy ditë, në mëngjes, para se ajo të nisej për në shkollë. Kjo histori tronditëse nuk u mor vesh për 10 vjet nga asnjë pjesëtar i familjes, derisa vajza u largua në moshën 18-vjeçare për shkak të studimeve. Atëherë vajza gjeti guximin t'i tregonte gjithçka kishte kaluar tezes së saj, dhe u dëshën plot 4 vite të tjera që ajo më në fund të merrte kurajën për të denoncuar në polici babain përdhunues. Pas denoncimit, babai përdhunues u arrestua në janarin e kaluar, por ajo që habit është se ai nuk ka pranuar asnjë akuzë duke thënë se e gjitha është fryt i fantazizë së vajzës së tij.




FMN: Shqipëria duhet të ecë me 1% më shumë se BE

Publikohet raporti i Fondit mbi Çështjet Ekonomike Rajonale të Evropës Qendrore e Juglindore

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka konfirmuar edhe një herë se ekonomia shqiptare ka konsoliduar tashmë trendin e qendrueshëm të rritjes së saj, ka deklaruar ministria e Financave, në një njoftim për shtyp, ku citon raportin mbi Çështjet Ekonomike Rajonale, publikuar dje nga FMN.

"Së pari, në Shqipëri raporti i pagës minimale ndaj pagës mesatare për vitin 2015 është mbi 45%, ose mbi nivelin mesatar në Europën Perëndimore dhe vendi ynë renditet i dyti pas Sllovenisë, për të gjitha vendet e CESEE", citon MF raportin e Fondit. Së dyti, vijon njoftimi, "risiku i stabilitetit politik në mars 2016 është reduktuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke kaluar nga intervale '50-60' në '40-50'".

"Së treti, Shqipëria është përjashtuar nga grupi i vendeve që ekspozojnë hapësira për rritjen e borxhit të jashtëm,




sikurse ka ndodhur me vendet e tjera për shkak të rënies në konsum dhe investimeve.

"Këto nuk janë thjesht vlerësime për ekonominë shqiptare, por janë rezultate të drejtpërdrejta të punës së maturuar dhe reformave të

thella të qeverisë në çdo sektor", thuhet në njoftimin e MF.

Dikasteri që qeveris financat e vendit pohon më tej se, ekonomia shqiptare në vitin 2015 u rrit me 2.62%, ose më shumë sesa mesatarja e rajonit.

"Në raport me vitin 2013, kur rritja ishte vetëm 1.1%, vitet 2014 dhe 2015 shënuan ndryshimet më të mëdha të rritjes në rajon", deklaroi MF në njoftimin e saj. Sipas saj, ekonomia shqiptare është ekonomia me trendin më të



Faksimile e raportit i Fondit Monetar për ekonominë e vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

qendrueshëm të zhvillimit në rajon, përkundër luhatjeve të theksuara të vendeve tona fqinje.

Por Fondi Monetar Ndërkombëtar në raportin periodik për zhvillimet rajonale të publikuar referoi edhe se Shqipëria dhe Serbia patën rritjen ekonomike më të ulët gjatv 2015 në mesin e gjashtë e vendeve të marra në krahasim. Rritjen më të lartë e kanë parë Mali i Zi dhe Maqedonia me respektivisht 4.1 dhe 3.7%. Ekonomia e Kosovës u rrit me 3.3 për qind dhe ajo e Bosnjës me 3%. Shqipëria vjen në vendin e gjashtë me 2.6% dhe pas saj vetëm Serbia me 0.7%.

FMN vë në dukje se, me këto ritme, vendet ende kanë

pak shanse të arrijnë konvergencën me standardet e jetesës me zonën euro. Me këto rritje ekonomike Shqipërisë do t'i duhen më shumë se 25 vite të arrijë nivelin e jetesës që Europa ka sot. FMN sugjeron që norma e rritjes në rajonin e Ballkanit duhet të jetë të paktën 1 për qind më e lartë se e BE-së, që konvergjenca të përshpejtohet.

Për periudhën afatmesme konsolidimi fiskal duhet të mbështetet, sa më shumë të jetë e mundur në kahun e të ardhurave, të tilla si përmirësimi i rritjes së taksës së karbonit dhe taksës së pronës. Nga krahu i shpenzimeve Fondi këshillon mbrojtjen e shpenzimeve produktive në investimet publike.

FORUMI I BIZNESIT / DISKUTOHET MPAKTI I NDRYSHIMEVE FISKALE NË BIZNES

Dhoma Amerikane kërkon transparencë për taksat vendore

Bizneset kërkojnë që të nis dialogun me Bashkinë për çështjen e taksave vendore. Artan Bozo, kreu i Komitetit të Taksave dhe Ligjeve në AmCham ka kërkuar dje që biznesi të asistojë në hartimin e ligjeve.

"Kërkojmë që të nisim dialogun me Bashkinë për këto çështje:

1. Dokumentet që kërkojnë për regjistrimin e një biznesi të ri
2. Dokumentet që kërkojnë për të paraqitur një kërkesë/ ankese
3. Tarifa e pastrimit të përcaktohet sipas llojit të aktivitetit. Për këtë të përdoret



Bashkia e Tiranës

kategorizimi i bizneseve sipas aktivitetit ekonomik që ato kryejnë sipas kategorizimit

që përdorin edhe organet tatimore

4. Interpretimi në lidhje

me tabelat që tregojnë llojin e shërbimit të ofruar, tabelat që shërbejnë për të treguar vendndodhjen e një subjekti

5. Çështja e NIPT-it sekondar. Përfaqësuesit tatimor, subjektet në likuidim e sipër, subjektet në status pasiv ose të pezulluar

6. Tarifa për infrastrukturën arsimore paguhet për çdo njësi (NIPT sekondar)

7. Konsultimi paraprak me grupet e interesit për nivelin e taksave, procedurat, problematikat.

Biznesi duhet të asistojë në hartimin e ligjeve"- tha Bozo. Këtë deklaratë ai e dha në

Forumit e Biznesit, të organizuar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë, me Bashkinë e Tiranës me temën "Ndryshimet në tarifat dhe taksat vendore, impakti i tyre në biznes".

I pranishëm në panel, nënkryetari i Bashkisë Tiranë, Arban Mazniku deklaroi se biznesi e ka derën e hapur, qoftë kjo edhe në hartimin e buxhetit. "Kemi ngritur Komitetin Ekonomik ku ka përfaqësi biznesi. Që qyteti të marrë shërbime duhen paguar taksa. Në 2015 buxheti ishte vetëm 55 mln usd."- tha z. Mazniku.

Ai shtoi se start up do t'u

mundësohet pagesa e detyrimeve në 3 muaj, nga 30 ditë që është afati sot.

"Në mbledhjen e ardhshme marrim vendim që të gjitha bizneset e reja t'u mundësojmë pagesat e detyrimeve në 3 muaj nga 30 ditë që është sot"- tha Mazniku.

Në forum, u bë e ditur se sa i përket tabelave, Bashkia ka përcaktuar që deri në 2 m2 të jetë me tarifë zero. Përfaqësuesit e Bashkisë deklaruan se 4 m2 është e mjaftueshme për informim, mbi këtë masë është jashtë logjike.

STATISTIKAT / VITIN E KALUAR SISTEMI KISHTE SHËNUAR RITJE TË NDJESHME

Bankat, fitimi në tremujorin e parë ra me 75 për qind

Fitimi i sistemit bankar ka shënuar një rënie të ndjeshme me 75% në tremujorin e parë të vitit, në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, që raporton me standardet lokale, sistemi rezultoi më një fitim prej 1.4 miliardë lekësh për janar-mars 2016, nga 5.86 miliardë lekë në tre muajt e parë të 2015-s. Rënia e të ardhurave nga interesat dhe veprimtaritë e tjera dhe rri-

tja e ndjeshme e shpenzimeve për provigjione ishin arsyt kryesore që ndikuan në këtë tendencë. Të ardhurat nga interesat u ulën lehtë, ndërsa të ardhurat nga veprimtaritë e tjera ishin -61 milionë lekë, nga 1.1 miliardë lekë në tremujorin e parë 2015.

Ndërsa shpenzimet për provigjione u rritën në 2.86 miliardë lekë, ndërkohë që në janar-mars 2015 kishin qenë negative. Tremujori i parë shënoi dhe një

rritje të kredive me probleme, pas uljes së tyre në fund të 2015-s, çka i detyroi bankat të kalojnë një pjesë të fondeve si shpenzime për të mbuluar kreditë e këqija në formën e provigjioneve.

Vitin e kaluar, fitimi i sistemit bankar sipas standardeve lokale shënoi një rritje të ndjeshme, kryesisht si rrjedhojë e diferencave në maturitetin e interesave të depozitave e kredive (interesat e depozitave u ulën

më shpejt pasi ishin më afatshkurtrë, në raport me të kredive). Por, tremujori i parë po e vë seriozisht sistemin përballë sfidës së normave të ulëta të interesit, çka pritet t'i bëjë bankat më të kujdesshme në sjelljen e tyre.

Pak ditë më parë, Banka e Shqipërisë uli normën bazë në një nivel rekord të ri duke e çuar në 1.25%, në një sinjal se bankat duhet të reduktojnë më tej koston e parasë, në mënyrë që të nxitët kreditimi.



DITARI I LUFTE

HAKI STERMILLI: JA E VËRTETA E Mbledhjes së Mukjes

Nga 30 korriku 1943, ditë pas dite zbardhen gjithë përgatitjet e mbledhjes së famshme që do të bashkonte dy kampet politike në një front të vetëm kundër pushtuesve...

PJESË NGA DITARI

Kaptina I.
30 korrik 1943.
Tiranë.

Aty kah ora 10 para dreke organ-izata e Frontit Nacional-Shlirimtar më kumtoi se duhej të largohesha nga Tirana për të marrë pjesë në një konferencë që do të bahet, diku, midis nesh e Ballit Kombëtar për një marrëveshje bashkëpunimi në luftë kundër okupatorit. M'u njoftue se lypsesha me u nisë në ças për shkak se më pritshin shokë të tjerë për me shkue së bashku. Për këtë arsye, pa u përshëndetë as edhe me pjestarët e familjes, vajta në shtëpi të Malo Frashërit, ku gjeta Dr. Ing. Gaqo Tashkon, Stefanaq Plumbin dhe Malon.

Ndërsa pritshim lajmin e nisjes, u njoftuem se, qysh në mëngjes, qenka rrethue Tirana prej Italianeve dhe s'paska mundësi me sigurue ndonji shteg daljeje. Me gjith këtë pritim deri m'ora 2 mbas mesdite.

31 KORRIK 1943 E SHTUNË.

N'ora 11 para dreke përsëri shkova në shtëpi të Malo Frashërit. Aty gjeta shokët e djeshëm. N'ora 1, në pikë të zhegut, u futëm në një veturë dhe u nisëm drejt Kodrës së Kuqe. Ishim: Ing. Dr. Gaqo Tashko, Stefanaq Plumbi, Malo Frashëri dhe un. Shoferi – pa dyshim i organizatës – na solli deri në buzë të lumit të Tiranës. Aty zbritëm dhe, pa ngurue, kaluem n'anë tjetër të lumit. Qëndruem mbi një kodrinë për me pushue dhe për me pritë udhëheqësin, i cili pa dyshim do t'ishite andej. Dhe me të vërtetë, mbas pak, një puntuer u shkëput nga mezi i atyne që përgatitshin zhur në lum dhe muer rrugën në drejtim t'onë. Kur u avit e ngriti grushtin përpjetë dhe na përshëndeti tue thirrë: "Vdekje Fashizmit".

Ky ishte udhëheqësi i jonë i maskuem nën petkat e puntorit katundar. Qubet Lym Keta. Asht Tiranasi. Na prini. Ma andej Ma andej hasëm në shokun Gogo Nushi. Së bashku e vazhduem rrugën. Për ku? S'dijmë dhe s'pyesim.

Gjatë udhtimit shpesh takuem në partizanë, të cilët na e tregojshin rrugën që duhej të ndiqshim. Partizanët, të strukun nën hijën e ferrave ase të lisave prej vapës që zhurrit, dukeshin befaz dhe, mbassi na pëshëndetshin me parullën "Vdekje Fashizmit" na përcjellshin me buzëqeshje. Dukja e tyne na kënaqte, pse për herë të parë i shifshim luftëtarët e lirës, të cilët na gjaishin si heroj legjendarë.

Në kohë të zamrës sosëm në katundin Herraj, ke shtëpia e Xhemal Herrit, këtu gjetëm shokët Dr. Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi dhe Ing. Spiro Koleka. Ma vonë erdh Dr. Omer Nishani, Sulo Bogdo, Dr. Medar Shtylla, Vasil Nathanaili dhe Shefqet Beja. Pa kalue shumë kohë arrini edhe Myslim Peza i shoqnuem nga dy çeta partizane. Seicila çetë kishte nja një flamur të madh. Të Shqipnis e jo të Rusis sikundër propagandojshin Ballistat në Tiranë e gjetiu. Ata ishin prej pëlhuere mundafshi dhe të qëndisun me fije ari e mundashi. Mbi njeinin ishin qëndisë edhe fjalët "Ja vdekje ja liri".

Partizanët i ngulën flamurët në shesh dhe, mbassi banë një qark rreth tyne, nisën me këndue kangë

Një varg ngjarjesh të rëndësishme nga Lufta, gjatë viteve 1943-1944, vijnë të përshkruara me një stil të veçantë në ditarin personal të shkrimtarit Haki Stërmilli. Një nga protagonistët Luftës, Stërmilli sjell në ditarin e tij shumë ngjarje, ku ka qenë i pranishëm apo ngjarje që ka dëgjuar nga dëshmitarë kyç. Ky ditar "asht pasqyra e vujejtjeve dhe e sakrificave mbijnërezore të popullit t'onë kreshnik, asht krijesa e heroizmit të Rinis s'onë t'artë. Ato që pashë, që ndigjova dhe që jetova gjatë përleshjes vigane të popullit t'onë me anmiqt, formojnë landën e kësaj vepre, e cila fillon me 30 Korrik 1943 dhe mbaron me 30 Nanduer 1944", shkruan Stërmilli në krye të ditarit të tij, ndërsa e nis me një prej ngjarjeve më të diskutuara të viteve të luftës marrveshjen e Mukjes mes Frontit Nacional Shlirimtar dhe Ballit Kombëtar. I ruajtur në fondin e kujtimeve në AQSH, nga ky ditar do ti sjellim lexuesve disa nga pjesët më interesante, duke e nisur me mbledhjen e Mukjes.

AD. PE

kombëtare e revolusjonare. Kangë luftë këndohen këtu, erë lirie fryn këndej.

Myslim Pezën e njof qysh para vjetit 1924. Asht i hollë dhe i gjatë. Fëtyra e tij asht nxi si të jet përcëllue prej diellit dhe asht thinjë tepër. Por syt i lëvizin me gjallni dhe gazi gjan sikur i shpërthen nga megjet e zemrës së kënaqun. Dr. Dishnica e Mustafa Gjinishi janë të rij. Në syt e Dishnicës këndohet lehtë inteligjenca që zotnon. Gjinishin e njof prej kohësh. Nuk ka ndrrue në dukje. Por vej re se intelekti i tij asht zhvillue mjaft, këto vjetët e fundit. Sigurisht kët përfitim e ka sigurue prej Marksizmit. Të dy janë të qeshun, si ata që jetojnë në siguri e lumni.

Dr. Ing. Gaqo Tashko i mshin syzat dhe hedh një veshtrim prej studjori rreth e rrotull. Gjan sikur don me e matë dobin që mund t'i sjellin Attheut tokat pjellore që e rrethojnë po të punohen simbas sistemit që ai din dhe me mjete moderne. Ing. Spiro Koleka, edhe ky me syza, admiron klimën dhe thotë:

- Këtu fryka sikur të kesh vu në funksjon njimij ventilatorë!

- Në kët kodrinë do t'ishite mirë të ngrihej një sanatorium – i a pret Sulo Bogdo.

- S'asht i përshtatshëm për sanatorium, pse ka korrent – verën Dr. Ymer Dishnica.

- Nji shkollë bujqësie do të shërbente ma fort se çdo tjetër – kujton Dr. Ing. Gaqo Tashko.

Në bisedim marrin pjesë Dr. Omer Nishani, Myslim Peza, Dr. Medar Shtylla, Gogo Nushi, Vasil Nathanaili, Ing. Spiro Koleka, Mustafa Gjinishi e tjerë. Të gjithë shfaqin mendime për prodhimin, ndërtimin e përmirësimin e vëndit.

Kur u duk se muer fund ky bisedim, Myslim Peza thiri një partizan – një djalosh, dhe e përkëdheli me fjalë. Mbasandaj të ktheje e më pyeti se a e njifsha.

- Jo – i thashë tue e shqyrtue fëtyrën e partizanit – S'kujtoj t'a kem pa ndonji herë.

- Ky asht ai që i muer nga Ministria e P. të Mbrendshme aktet e Zyrës Sekrete dhe e bani për të vramë vetëhen Kolë Bibë Mirakajin – spjegoi Myslimi dhe shpërtheu në gaz.

I hodha një shiqim djaloshit. Në fëtyrën e tij të re valvjetë nënqeshja e ngadhnuesit. I pyetun, kallzoi se si, i urdhënuem prej Partis, kishte lanë shkollën dhe si kishte arri me e krye minisoin. Ma në fund shtoi:

- Un jam i pasun. Ju siguroj se po të kërkonte Kolë Bibë Mirakaj me u ba shërbëtuer në shtëpi t'eme, nuk do t'a pranojshim, pse ai s'din me i shërbye një familjeje qërron në një pallat.

- E ç'të shtyeni me e përbuzë

pallatin dhe me i marrë malet me rrezik jete?

- Ideali – gjegji me vendosmëni e krenari.

- I shef këta të rij? – m'a bani Myslimi – janë zjarr. Sa ma të rij të jenë, aq ma trima janë.

Dhe Baba – kështu e thresin Partizanët Myslimin – vazhdoi të më rrëfejë episode të ndryshme trimënie të kryeme prej tyne. Mbete me gisht në gojë.

Muzgu i mbames shtrihet lehtas dhe na e kujton nevojën me hy mbrenda. Partizanët, me bar e kashtë, përgatitshin vendin e fletjës në fushë të hapët. Baba Myslimi i porosit mos harrojnë me i lanë edhe atij një vend. Ai, simbas zakonit, flet bashkë me ta. Nuk ndahet prej tyne si ati prej fëmij.

Shtëpia e Xhemal Herrit asht ndërtue kur hante maca petulla!... Ashti një banesë qyteti me shum këthina, me salla e konforte. U grumbulluem, të gjithë, në një sallë. Dr. Omer Nishani, me një varg kritikash e autokritikash plot humor, dikton gaz e hare në të gjithë.


Mbas mezit të natës, kur po bajshim gjumin e parë, arrini Hysni Lepenica me çetën e tij për të marrë pjesë në konferencë si përfaqësues i Ballit Kombëtar.

1 GUSHT 1943.

Në mëngjes u nisëm për në katundin Mukaj, ku do të bahet mbledhja.

Me dam u ndava nga shtëpia e Xhemal Herrit, pse më kishin vjedhë një këmishë, një fanellë, një palë brekë, një palë corapë e nja dy shamë. Tash s'kam më ndresa tjera vec këtyne të shtatit. Tue u ngjitë kodrinave, mbas një udhtimi të lodhshëm, sosëm në Mukaj.

Këtu në Mukaj, janë mbledhë ma shum se 400 vetë. Balli Kombëtar i ka mobilizue të gjitha forcat e veta prej intelektualësh e bashibozukësh që t'a demonstroj fujqin. Hysni Lepenica me çetën e tij ka ardhë si



ngadhnimtar, sepse paska kalue – sikundër thotë ai – përmes rreziqesh me që i qenka dashtë me udhtue nëpër zona të kontrollueme prej ushtrisë Fashiste Italiane. Mirë, por na dijmë se Ali Këlcyra e Nuredin Vlora, nëmën të Ballit, kanë nënshkruar një marrëveshje mosmulumimi me Gjeneral Dalmazzo-n. Me gjith këtë duhet të heshtim. Trimat e Ballit janë të mveshun, të mbathun e t'armatosun fare mirë. Të shumët kanë nga dy rrypa fishekësh të kryqëzue mbi krahënorë. Kanë revole, bomba, dybli dhe çanta si ato që mbajnë oficerat e shtatmadhoris. Edhe na kemi këtu tri çeta. Por këta tonët, qysh nga partizani i thjeshtë deri ke Komandanti ase Komisari



Haki Stermilli

Faksimile e disa prej faqeve të ditarit të luftës së Haki Stermillit

ndër shokë t'ona, nisi me ndikue një farë mosbesimi.

Dekallogu i Ballit Kombëtar, sikundër dihet, asht ma i pasun se ai i Moisiut që i diktoi Jehovah-i. Nji ndryshim të vetëm ka midis tyre: Ai ishte kushtue me u zbatue në këtë jetë, kurse ky i Ballit për atë jetë; ai përmbante një varg porosinash moralofetare, kurse ky i Ballit rrjeshton një grumbull dëshira utopike dhe marrëzira që s'përtypen fare. Nji ndër lakmit e mëdha të Ballit asht edhe sigurimi i aneksimit të Shqipnis ethnike, e cila u duket si një Kanisqë, si një dhanti hyjnore që mundet me i ngopë. Sidomos Kosova e pasun e pjellore ua ka terrarisë syt dhe u a ka shtue tepër lakmin e zotnimit e të shfrytëzimit të saj. Për këtë shkak ata sod folën mjaft mbi këtë pikë. Në diskutim e sipër Midëhat Frashëri m'u vërsul dhe më kritikoi:

- E ndiguiat Zotërinjë, se Zotni Haki Stermilli nuk e dashka Dibrën e Kosovën...

Kur i u përgjigja dhe i thashë se un, ma fort se cילוd prej tyre, kisha luftue për sigurimin e të drejtave të popullit t'atyna krahinave, heshti e nuk u ndi fare. Ma vonë, kur bamë disa minuta pushim, më kapi për krahu dhe më lypsi ndjesë tue u mundue t'a korrigjonte gabimin. Politikanët e mëdhej (!) të tipit të Midëhat Bej Frashërit, me të vërtetë, dijnë me qortue e me fye, por dijnë edhe me korrigjue! Lum Lumo Skendoja!...

2 GUSHT 1943. E HANË.

Edhe sod, tanë ditën, vazhduen bisedimet, të cilat disa herë u ashpërsuen për shkak t'arrogancës së Ballistave. Mbas dreke vonë, muerën fund dhe u arrit në një marrëveshtje.

Ballistat kërkuen që sonte t'a sulmojmë e t'a shlirojmë Kruen dhe, mandej, prej andej, ta deklarojmë të rrezuem nga Froni i Shqipnis Viktor Emanuelin e III-të tue e shpallë edhe lirin dhe independencën e Shqipnis. Mrekulli!... Por si se? Ata ngulnuen në propozimin e tyre nga droja se mos kapitulloje Italia pa gëdhi dita e nesërme dhe atëherë para botës do t'a humbshin vlerën e politikaneve të mëdhej që kanë zotësi parashikimi për ngjarjet që do të zhvillohen. Kruen, s'don mend, duhet t'a sulmojmë e t'a shlirojmë partizanët. Mbasandaj ata të hyjnë si ngadhëmtarë dhe prej kështjellit historik të Kruës t'i flasin botës me gjuhën e Cezarit. Kruja strategjike, e forcuar edhe prej Italianëve për me mprojtë krahët e Tiranës, padyshim, nuk asht nga ata mollë që mund të bahet aq lehtë, me gjith që Ballistave u shkojnë jargët për të. Na që fitoret e luftës i masim dhe i sigurojmë me koka shokësh e shogesh, nuk mund të merrshim një përgjegjësi kaq të madhe vetëm e vetëm për të kënaqë kapricjet e Ballistave. Prandaj s'pranuam. Por kur pamë se ata ngulmojshin, u propozuam që ata

politik, janë të reckosun dhe të mveshun me lloj lloj petkash e ngjyrash. Gjan sikur u ka mungue gustoja apo estetika këtyne t'onëve. Ballistat civilë, që janë importue nga të katër anët e Shqipnis, t'a ngopin synin me elegancën e tyre të pamohueshme. Kiju mën, por epu hakun. Dijnë me u mveshë ashtu edhe me jetue! Qeh: shum prej tyre kanë sjellë me vetëhe shtret të nortafit, shezlongë, pixhama, takëme kafeje e tjera. E po

kështu dilet nëpër male me luftue për ... liri!...

Para se të fillojshin bisedimet, Ballistët kërkuen që na të shënojmë 6 delegatë e ata 12. Shkak i këtij mosbarasimi na paska qenë ke fakti se ata e përfaqësuekan të tanë popullin kurse na vetëm një pjesë të vogël!... Natyrisht, na kundërshtuem dhe ata, mbas shumë diskutimesh, pranuen që numuri i delegatëve të jet i njëjtë. Prej nesh u zgjodhën: Dr. Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Shefqet Beja, Dr. Omer Nishani, Dr. Medar Shtylla, Sulo Bogdo, Myslim Peza, Dr. Ing. Gaqo Tashko, Malo Frashëri, Stefanaq Plumbi, Bazi i Sanës dhe un. Ata u përfaqësuen prej: Midëhat Frashëri, Thoma Orologaj, Skënder Muço, Hysni Lepenica, Jusuf Luzaj, Kadri Cakrani, Nexhat Peshkëpia, Hasan Dosti,

Midëhat Araniti, Ismail Petrela, Halil Mëniku dhe Vasil Andoni. N'anën t'onë, si ndigues, merrte pjesë: Ing. Spiro Koleka, Gogo Nushi e Vasil Nathanaili. Kurse prej tyre: Ali Këlcyra, Nuredin Vlora, Aziz Cami, Etëhem Haxhiademi, Xhemal Herri, Halil Maçi, Ihsan Toptani e shumë të tjerë.

Në një shesh gjysmë të gjelbëruem, ku bajnë hije disa rranjë ullaresh shekullorë, sod mbas dreke u hap mbledhja. Kryetar i mbledhjes, simbas propozimit t'onë, u zgjodh Thoma Orologaj dhe sekretar Mustafa Gjinishi. Rendi i ditës ka qenë caktue e vendosë disa ditë ma parë në Tapizë, ku u ba takimi i parë midis delegatëve t'onë e të Ballit Kombëtar. U hap mbledhja dhe u këndue rendi i ditës. I pari kërkoj fjalën Hysni Lepenica. Syt e të gjithëve u drejtuan kah ai dhe veshët u mbajtën në përgjim për me ndiguesë a ma mirë. Hysniu, në vend që të flite mbi pikën e parë të rendit të ditës, kërkoj me dritë se Fronti Nacional-Shlirimtar a ishte një organizatë Komuniste e deklarue me qorëkonte me u maskue nën velon e nacionalizmit me parulla të ndryshme.

- Pyet shokët e të ... që banë akordin në Tapizë - i u përgjegj një nga t'onët.

S'kemi ardhë këtu që të vihemi në bankon e t'akuzuemve - plotosi një shok tjetër prej nesh.

Por Hysniu vazhdoi. U vërsul me tërbim kundër komunizmit; shfren kundër këtij gogoli që e tremb Ballin Kombëtar ma fort se Fashizmi! Fjala e tij qe paralajmërimi i mosmarrëveshtjes, qe parathanjë e asaj disarmonije që, sigurisht, ka me plakosë në t'ardhmen. Për këtë shkak u hap shtegu i një diskutimi që vazhdoi disa orë. Na provuem se ishim patriotë e Komunistë të grumbulluem në Frontin Nacional-Shlirimtar dhe se kemi për qëllim me luftue për shlirimin e Atdhut të robnuem. Në një kohë kur kapitalistët Anglo-Amerikanë janë lidhë ngushtë me Rusin Bolshevikë për me u luftue Fashizmin Italo-Gjerman, Ballistat t'onë dreqjnë me bashkëpunue me Komunistat Shqiptarë!... Vallë përse? Na e

dijmë dhe atyne nuk u bjen për shtati me e thanë hapët e troç.

Mbas shumë diskutimesh, me zi, hymë në rendin e ditës. Me gjith atë gjithmonë fjala ngecte dhe mbetesh pezull, pse ata përpiqeshin me nxjerrë keqkuptime dhe bashjshin provokime. Prandaj bisedimet shkojshin vërdallë dhe nuk kthjellseshin. Shkurt u kam formue bindjen se Ballistave u mungon sinqeriteti, u mungon qellimi i vërtetë për një marrëveshtje, për një bashkëpunim. Për këtë arsye edhe





Pamje nga rapsodë popullore



Eposi i Kreshnikëve vlerësohet me çmimin “Europa Nostra”

Çmimi shënon një hap shumë të rëndësishëm drejt kalimit përfundimtar të Futjes së Dosjes në UNESCO

Një hap shumë të rëndësishëm është hedhur në bashkëpunimin me UNESCO për Eposin e Kreshnikëve, ciklin e këngëve legjendare shqiptare. Zyra Europiane e promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, Creative Europe ka vlerësuar me çmimin special Europa Nostra dosjen e përgatitur nga specialistët shqiptarë, Eposi i këngëve epike legjendare të Kreshnikëve. Ky çmim shënon një hap shumë të rëndësishëm drejt kalimit përfundimtar të Futjes së Dosjes së Eposit të Kreshnikëve në UNESCO. Çmimi Europa Nostra është një vlerësim i trashëgimisë kulturore shqiptare, që ende jeton në pesë shtete, ku ka etnitete shqiptare si në Mal të Zi, Kroaci e më gjërë. Dosja e eposit të Kreshnikëve nisi përgatitjet që në vitin 2012, ku studiuesit kanë dhënë alarmin për zhdukjen e kësaj tradite muzikore që këndohet me lahutën antike. Veçanërisht në trevat shqiptare nuk mund të gesh më shumë se dhjetë lahutarë pohojnë studiuesit.

PLAKU 105-VJEÇAR GJOK NONAJ

Një shembull i rrallë i mbijetesës së eposit është plaku 105-vjeçar Gjok Nonaj, i cili në Festivalin Folklori të Gjirokastrë 2015 ka

interpretuar këngë legjendare në lahutë, traditë që ia ka trashëguar edhe së bijës. Studiuesit shqiptarë dhe të huaj po gjurmojnë e dokumentojnë elementë të hershëm të kësaj tradite në Kosovë në Ma të Zi e më gjërë. “Globalizimi dhe faktorët ekonomikë rrezikojnë zhdukjen e këtij eposi, veçanërisht në trevat shqiptare, ku lahutarët nuk numërohen më shumë se dhjetë të tillë. Lahuta, si instrumenti thelbësor i muzikës së eposit, gjithnjë e më shumë po del nga qarkullimi, pohon muzikologu Vaso Tole, duke vlerësuar në kontributin e dhënë për dosjen studiuesit kosovare dhe studiuesit shqiptarë Shaban Sinani e Gjovalin Shkurtaj.

DOSJA EPOSI SHQIPTAR NË PESË SHTETE (E5)

Me vendimin nr. 02/103 të datës 14.01.2010 Qeveria e Kosovës miratoi krijimin e komisionit qeveritar për përgatitjen e dosjes së regjistrimit të Eposit Heroik Legjendar në listën e UNESCO-s për trashëgiminë jomateriale të



Për të parë videon në smartphon tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

Njerëzimit. Në përbërje të këtij komisioni u caktuan prof. dr. Zymer Neziri (IAP), prof. dr. Shaban Sinani (IGJL) dhe prof. dr. Vasil Tole (ASH). Pas më shumë se gjashtë viteve pune kërkimore, dosja për regjistrimin e Eposit në UNESCO u përfundua dhe u dorëzua. Në këtë proces komisioni është zgjeruar edhe me bashkëpunëtorë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Në shërbim të këtij nominimi janë organizuar disa ekspedita kërkimore në terren dhe dy konferenca shkencore ndërkombëtare. Në procesin përfundimtar dosja shkencore e nominimit të këngëve heroike legjendare shqiptare u depozitua me titullin Eposi shqiptar në pesë shtete (E5). Për shkak të vështirësive të karakterit diplomatik, procesi i regjistrimit të E5 në listat e trashëgimisë kulturore të Njerëzimit ende nuk është përmbyllur. Me datën 4 maj, The Voice of Cultural Heritage in Europe, Zyra Europiane e Promovimit të Vlerave Themelore të Trashëgimisë Kulturore, e njohur

më shkurt me emrin Creative Europe, vlerësoi me Çmimin Special Europa Nostra dosjen e përgatitur nga specialistët shqiptarë, me titullin analitik Eposi i këngëve heroike-legjendare - përmendore e trashëgimisë kulturore në Ballkan. Ky çmim është i kategorisë Dosje kërkimore dhe shënon një hap shumë të rëndësishëm përpara në rrugën drejt regjistrimit përfundimtar të kësaj trashëgimie në listat e UNESCO-s. Çmimi është një vlerësim para së gjithash për trashëgiminë shpirtërore të popullit shqiptar, e njohur tashmë edhe zyrtarisht si pasuri ballkanike dhe përbërëse e Europa Nostra. Komisioni qeveritar për përgatitjen e dosjes shkencore është kryesuar gjatë gjithë periudhës 2010-2016 nga prof. dr. Zymer Neziri. E5 është e para pasuri që fiton çmimin Europa Nostra si propozim i Qeverisë së Kosovës. Akademia e Shkencave do të organizojë së afërmi një ceremoni përmiruese për dosjen shkencore E5 dhe për çmimin e merituar Europa Nostra. Ky çmim është një hap tjetër përpara jo vetëm për certifikimin e vlerave europiane të trashëgimisë kulturore shqiptare, por edhe për ndryshimin pozitiv të statusit të Kosovës në kuadër të organizatave ndërkombëtare, si UNESCO.

KOMEDIA / VEPRA SHFAQET NË TEATËR KAME

“Të gjithë me huqe” në Ibë, homazh për Roland Trebickën



Roland Trebicka dhe Robert Ndrenika

Teatër Kame në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar Tiranë dhe Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” do të shfaqin më 6 maj komedinë “Të gjithë me huqe” të autorit Laurent Baffie. Premiera ngjitet në skenë nga Gëzim Kame me aktorët Viktor Zhusti, Rajmonda Bulku, Genci Fuga, Eriona Kakeli, Elia Zaharia, Lulzim Zeqja, Arjola Basho me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Teatër Kame. Organizatorët pohojnë se do të jetë pjesëmarrës edhe Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe personaliteteve të larta

politike të vendit. Një pjesëmarrje e tillë e ka një arsye, sepse premiera “Të gjithë me huqe” do të jetë një homazh për aktorin e ndjerë Roland Trebicka, i cili në këtë shfaqje luante rolin e tij të fundit komik. Komedia “Të gjithë me huqe” ka njohur një sukses të madh në skenat e Parisit dekadën e fundit. Ngjarja zhvillohet në dhomën e pritjes së kabinetit të një psikoanalisti të madh. Gjashtë pacientë të profesioneve dhe çrregullimeve të ndryshme të sjelljes (Tok) presin me orë të tëra mjekun e famshëm i cili nuk vjen dot kurrë për shkak

të një vonese avioni. Ndërvëprimi mes tyre gjatë kësaj pritjeje të gjatë është objekt situatash komike të pafund, marrëdhëniesh njerëzore të sjellja me zgjuarsia nga autori Baffie. Shfaqja do të jetë në skenën e Teatër Kame në Ibë gjatë të gjitha fundjavave verore në orën 20. “Një gotë verë në dorë dhe të qeshura pa fund do të shoqërojnë spektatorin nëpërmjet artistëve më të njohur të skenës shqiptare përgjatë 1 ore e 30 minutash e duke vazhduar darkën deri në agim në një atmosferë festive dhe art kulinar.”, pohojnë organizatorët.

Historike, Londra për herë të parë me kryebashkiak mysliman

Laburisti Khan është me origjinë pakistaneze, fiton me 44%

Kandidati laburist, Sadiq Khan ka fituar garën për kryebashkiak të Londrës, edhe pse numërimi i votave nuk ka përfunduar totalisht. Zgjedhësit londinezë duket se e kanë vendosur laburistin përpara rivalit të tij më të afërt, konservatorit Zac Goldsmith, ndaj të cilit udhëheq me 44,3% të votave kundrejt 34,8%. Deri më tani janë mësuar 11 nga 14 vendet e Asamblesë së Londrës. Konservatorët kanë fituar në Croydon and Sutton, Bexley and Bromley, Havering and Redbridge, South West, si dhe West Central, ndërsa laburistët kanë fituar 8 të tilla, duke u rrëmbyer konservatorëve Merton and Wandsworth, përveç Barnet and Camden, Brent and Haringey, Greenwich and Lewisham, Lambeth and Southwark, City and East, si dhe Ealing and Hillingdon. Numërimi i votave në "Alexandra Palace", "Excel" dhe "Olympia"



Sadiq Khan

→ LONDRA

Kryebashkiaku i ri i kryeqytetit britanik do të mbajë mandatin më të rëndësishëm personal se çdo lloj posti politik në Britaninë e Madhe. Ai kontrollon transportin, rendin, mjedisin, strehimin e planifikimin

ka përfunduar në mënyrë elektronike.

Ndërkaq, sipas redaktorit politik të BBC-së, Tim Donovan, "duket se pas skandimit dhe leximit të rreth 80% të votave, Khan udhëheq me 44% kundrejt 35% të Gold-

smith". Pjesëmarrja në këto zgjedhje lokale duken shumë më të larta sesa në vitin 2012, me një rritje prej 7% duke shkruar në 45%, shton më tej Donovan.

E tekta numërimi vazhdon, Khan është shprehur se "ndihet gjithmonë nervoz". "Jam ndoshta njeri më pak i vetëkënaqur që ju mund të hasni diku, megjithatë edhe mua më pëlqen moti i mirë dhe jam duke e shijuar këtë ditë të bukur me diell", deklaroi Khan. "E kam adhuruar të gjithë fushatën që bëra, më ka pëlqyer jashtë mase të bisedoja me londinezët dhe mund të them se 24 orët e fundit kanë qenë fantastike".

Votuesit kanë pasur

mundësi të zgjedhin preferencë të parë dhe të dytë për kryebashkiak, si dhe për dy tipet e anëtarësisë së Asamblesë së Londrës, një për zonën e tyre dhe një për qytetin.

Kryebashkiaku i ri i kryeqytetit britanik do të mbajë mandatin më të rëndësishëm personal se çdo lloj posti politik në Britaninë e Madhe. Fituesi mes Khan dhe Goldsmith do të pasojë Boris Johnsonin, i cili mposhti në zgjedhjet e kaluara Ken Livingstone. Kryebashkiaku ka kontrollin mbi katër fusha të rëndësishme në Londër: transportin, rendin, mjedisin, si dhe strehimin dhe planifikimin, ndërkohë që të gjitha vepimet e tij mbikëqyrin nga Asambleja e Londrës.

SKANDALI/ MIJËRA VIP BOTËRORË FSHEHIN PARATË NË PARAJSA FISKALE

Zbulohet autori i daljes së materialeve "Panama Papers"

Skandali i ashtuquajtur "Panama Papers", i cili shkaktoi një valë të madhe reagimi mbi pasuritë e udhëheqësve botërorë, tashmë e ka një zë dhe është pikërisht burimi anonim që fshihet pas rrjedhjes së dokumenteve të pafundme, por që kërkon mbrojtje në këmbim të ndihmës ndaj autoriteteve për të kryer hetimet e nevojshme. Në një deklaratë prej rreth 1.800 fjalësh, "John Doe", pseudonimi i personit që nxorri sekretet, bën të ditur se nuk ka punuar kurrë për ndonjë agjenci spionazhi apo për llogari të ndonjë qeverie. Ai e nis deklaratën duke cituar "barazinë e

të ardhurave" si motiv për veprimin e bërë. "Panama Papers", apo "Letrat e Panamasë", nxorren në pah sesi disa persona tepër të pasur përdorin firma "offshore" për të shmangur pagesën e taksave dhe për të shmangur sanksionet. Letrat i përkasin kompanisë ligjore "Mossack Fonseca", por personi anonim mohon të ketë kryer ndonjë shkelje, dhe se ai është thjesht një viktimgë e piratimit kompjuterik.

Letrat e publikuara u hetuan nga qindra gazetarë investigativë, të cilët punojnë në mënyrë sekrete nën të ashtuquajturin Konsorcium Ndërkombëtar i Gazetarëve Inves-



tigativë (ICIJ) prej muajsh. Dokumentet zbuluan pasuritë e fshehta të qindra politikaneve, zyrtarëve, udhëheqësve aktual apo të dikurshëm, personaliteteve apo yjeve futbolli.

Në dokumente listohen më shumë sesa 200 mijë kompani mëmë, fondacione dhe truste, të ngritura të gjitha nëpër "parajsë fiskale" anëmbanë botës. Deklarata e "John Doe" erdhi vetëm pak përpara se Presidenti amerikan, Barack Obama, të jepte një deklaratë mbi ekonominë, në të cilën citoi se "Panama Papers" thekson edhe më shumë problemin e korrupsionit dhe evazionit fiskal.

Kundërshtia

TIRANË

Në do të ndjekim rrugën tonë, ju po të doni ndiqni tuajën". Kështu i është përgjigjur presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan, njëherë prej kërkesave të Bashkimit Europian për të ndryshuar ligjet e vendit euroaziatik, në këmbim të udhëtimit pa viza për qytetarët turq në zonën "Schengen". BE-ja kishte kërkuar nga Turqia që të qartësonte përkufizimin e kësaj të fundit mbi termin terrorizëm, në mënyrë që të kualifikohet për mundësinë e heqjes së vizave, si pjesë e një marrëveshjeje më të gjerë mes të dy palëve, që do të shërbente për lehtësimin e krizës së emigrantëve në Europë, më e rënda që prej Luftës së Dytë Botërore.

Erdogan ka folur për me-

Turqia s'pranon kushtet e Bashkimit European për vizat

Rexhep Taip Erdogan: "Ne do të ndjekim rrugën tonë, ju ndiqni tuajën"

diet vetëm një ditë pasi kryeministri Ahmet Davutoglu, i cili ka qenë edhe negociatori kryesor i marrëveshjes me BE-në, tha se do të largohet nga posti që mbante, pikërisht prej mospërputhjeve të mendimeve me presidentin e vendit. Davutoglu raportohet të ketë kundërshtuar gjithashtu planin e Erdoganit për t'i dhënë më shumë pushtet Presidencës. Sipas Erdoganit, ndryshimet

e propozuara kushtetuese janë të një rëndësie kombëtare, e jo kërkesa personale. Marrëveshja mes BE-së dhe Turqisë përfshin rikthimin e emigrantëve, kryesisht refugjatë sirianë, nga Greqia për në shtetin e shtrirë në dy kontinente, duke llogaritur këtu edhe një rritje të theksuar të ndihmave dhe masave të tjera për ata që strehohen tashmë në Turqi. E gjitha kjo do të bëhej me një lëshim, që

do t'u mundësonte shtetasve turq lëvizjen e lirë për qëndrim afatshkurtra turistike në vendet e zonës "Schengen".

BE-ja ka bërë të ditur së fundi se dëshiron prej Turqisë të përcaktojë me fjalë më të përgjendruara kuptimin e gjerë të fjalës terrorizëm, në mënyrë që t'i përafrohet me standardet e BE-së. Ky ishte edhe njëri prej 5 kritereve të BE-së, që Turqia ende nuk i ka përmbyllur në mënyrë që



Rexhep Taip Erdogan

t'i mundësohet lehtësimi i vizave. Megjithatë Erdogan e ka refuzuar këtë, teksa në një dalje televizive të së premtes është shprehur: "Bashkimi Europian po na kërkon të ndryshojmë

ligjin antiterror, pikërisht në kohën kur Turqia gjendet nën sulmet e organizatave terroriste të të gjitha kaheve. Si mund ta kërkojnë këtë në këmbim të heqjes së vizave?"



Tirana 8 ndeshje pa tifoze, Partizani nuk merr pikët

Komisioni i Disiplinës ka dënuar me 10 ndeshje Mukën, por s'ka pranuar kërkesën e të kuqve për fitore në tavolinë

A shtu siç kishte paralajmëruar Federata Shqiptare e Futbollit nuk i ka toleruar aspak incidentet e dhunshme që ndodhën në derbin Tirana-Partizani. Komisioni i Disiplinës në FSHF ka shpallur dje vendimet për dhunën në këtë ndeshje. Disiplina ka ndëshkuar Tiranën me 8 ndeshje pa spektatorë. Gjithashtu është dënuar me 10 ndeshje pezullim nga aktiviteti, drejtori teknik i bardhebluve, Devi Muka, protagonist kryesor në episodet e dhunës. Po kështu është dënuar edhe drejtori ekzekutiv, Sajmir Shehri me një vit plus pezullim si dhe duke u gjobitur në shumën 500 mijë lekë të rinj Shehri nuk ka qenë protagonist në episode e dhunës por ai është dënuar për mosrespektim të dënimit të mëparshëm, sepse ka qenë i dënuar me 2 vite për të mos hyrë në stadium. Nga ana tjetër, klubi i Partizanit u dënua me gjobë 200 mijë lekë për sjellje të gabuar të spektatorëve duke dëmtuar stolat e stadiumit, hedhur flakadanë dhe stola në fushën e lojës, ndërsa zyrtari i klubit të kuq, Amarildo Dajlani, për sulm ndaj kundërshtarit, është dënuar njëloj si Muka, me 10 ndeshje pezullim nga aktiviteti.

"JO PIKËT NË TAVOLINË"

Nërkohë Komisioni i Disiplinës ka rrëzuar kërkesën e Partizanit për fitimin e ndeshjes



Pame nga dhuna në ndeshjen Tirana-partizani

në tavolinë. Partizani kishte kërkuar që të merrte pikët në tavolinë, duke u mbështetur në nenin 65 të KDS. Disiplina e hodhi poshtë këtë kërkesë me arsyetimin: "Komisioni arsyeton se, ndonëse jemi përpara dështimit në përbushjen e përgjegjësisë nga ana e KF "Tirana", ky dështim nuk është siç parashikohet nga dispozitat e Nenit 65/3/b pasi nuk konstatohet ndërprerje të lojës, hyrje në fushë të personave që kanë shkaktuar akte të dhunës ndaj lojtarëve ose zyrtarëve të ndeshjes"

DËNIMET PËR DERBIN

1. KF "Tirana", për dështim në përbushjen e përgjegjësisë, duke mos garantuar sigurinë e zyrtarëve të klubit kundërshtar pas ndeshjes dhe përgjegjësinë për sjelljen gabuar të spekta-

torëve, bazuar në nenin 32, 65 dhe 66 të KDS, dënohet 8 (tetë) ndeshje pa spektator. Zbatimi i dënimit llogaritet për ndeshjet brenda dhe jashtë stadiumit përkatës;

Në bazë të Nenit 13 të KDS, paralajmërimin e KF "Tirana", për përshkallëzimin e masave disiplinore në rast të përsëritjes së shkeljes përkatëse;

2. Zyrtari i KF "Tirana", Devi Muka, për sulm ndaj zyrtarit të ekipit kundërshtar, dënohet me 10 (dhjetë) ndeshje pezullim nga aktiviteti, bazuar në nenin 48/2/b.

3. Zyrtari i KF "Tirana", Sajmir Shehri, për sjellje ofenduese ndaj zyrtarit të ndeshjes, dhe mos respektim të vendimit të mëparshëm ndaj tij, dënohet me ndalimin e hyrjes në stadium, si dhe dënim me gjobë në masën 500.000 lekë (pesë-

qindmijë) bazuar në Nenin 21, 49/2/c dhe 49/3 të KDS.

4. KF "Partizani", për sjellje të gabuar të spektatorëve duke dëmtuar stolat e stadiumit, hedhur flakadanë dhe stola në fushën e lojës, dënohet me 200.000 (dyqindmijë) lekë gjobë, bazuar në nenin 66/1 të KDS.

5. Zyrtari i KF "Partizani", Amarildo Dajlani, për sulm ndaj kundërshtarit/personave të tjerë, dënohet me 10 (dhjetë) ndeshje pezullim nga aktiviteti, bazuar në nenin 48/2/b.

6. Bazuar në nenin 107 të KDS i kërkohet Sekretarisë që nëpërmjet Inspektorëve të Disiplinës të identifikojë:

a) të gjithë individët që janë përfshirë në akte dhune dhe nuk janë identifikuar ende nga zyrtarët e FSHF.

b) Dëmet materialet në stadiumin Selman Stermasi, shkaktuar në sektorin mik.

7. Rëzimin e kërkesës së KF "Partizani" për marrjen e masave disiplinore me humbjen e ndeshjes "Tirana-Partizani" në tavolinë në favor të "KF Partizani";

Komisioni arsyeton se, ndonëse jemi përpara dështimit në përbushjen e përgjegjësisë nga ana e KF "Tirana", ky dështim nuk është siç parashikohet nga dispozitat e Nenit 65/3/b pasi nuk konstatohet ndërprerje të lojës, hyrje në fushë të personave që kanë shkaktuar akte të dhunës ndaj lojtarëve ose zyrtarëve të ndeshjes.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Shkojnë për të grabitur por dhunohen nga familjarët, rëndë 2 hajdutët
- Eneda Tarifen e 'braktisin' në Eurovision, performanca më e dobët
- Babai e përdhunonte prej 10 vitesh e rrithe...historia që do t'u rrëngëthë
- Haxhia-Berishës: Po ngushtohet laku, e afërt dita e përballjes tonë
- Fier, kapen me drogë, përleshjen me policinë, ai e qëllon me armë
- Basha: Ja kush janë drejtuesit e Policisë të lidhur me Shullazin
- Radio Televizioni Publik Shqiptar tani me drejtor të ri, ja kush është
- Vrasja e Çiçajt, Efektivit mohon akuzën: Nuk kam fshehur prova
- Stërmbesa e Skënderbeut uron stërgjyshin e saj për ditëlindje
- Vendimi i qeverisë, Klubi i Dinamo i kalon në pronësi Bashkisë Tiranë

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Shkojnë për të grabitur por dhunohen nga familjarët, rëndë 2 hajdutët
- Haxhia-Berishës: Po ngushtohet laku, e afërt dita e përballjes tonë
- Doda: Reforma të mos votohet qorrazi, ne jemi shtet sovran
- Mandati i Kokëdhimës, Berisha: Rama po i bën presion gjykatësve
- PD: Tahiri pakt me bandat, 30% të shumës në këmbim të paprekshmërisë

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

Asllan Sula: Berisha ka rrjedhur umë bëj biznes me lekët e mia



PD, PS e LSI refuzojnë takimin me ambasadorët Lu e Vlahutin

'Drejtuësia' / Drafti amerikan, tre nenet që godasin korrupsionin




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

A duhet të marrin pjesë ambasadorët në mbledhjet e partive politike?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Behet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.693 KOMENTET E DJESHME

281.776 TOTALI LIKE

Seria A Zyrtare, Allegri rinovon me Juven deri në 2018

— Massimiliani Allegri do të vazhdojë të drejtojë Juventusin deri në 2018. Trajneri ka firmosur dje rinovimin e kontratës me klubin bardhezi. Lajmi është zyrtarizuar nga klubi torinez në rrjetin social Instagram me foton e trajnerit duke firmosur kontratën e re në krah të Drejtorit të Përgjithshëm Bepe Marrota. Me këtë kontratë Allegri bëhet trajneri më i paguar në Serie A, pasi do të marrë 5 milionë euro në sezon.



Massimiliani Allegri

Euro 2016 Italia në alarm, Verratti humbet Europianin

— Lajm i tjetër i keq për trajnerin e kombëtares italiane Antonio Conte. Pas Marchisio, dëmtohet edhe Marco Verratti. Mesfushori i Paris SG ka vendosur të operohet më 16 maj në qendrën e specializuar Aspetar në Doha, për të zgjidhur përfundimisht problemet me pubalgjinë dhe sipas menaxherit të tij Donato Di Campi, nuk mund të marrë pjesë në Euro2016. Pa dy nga pikat referuese të mesfushës Antonio Conte është i detyruar të kërkojë për alternative.


FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 35 KUTI



HORIZONTAL

- Janë falkhorët me letra.
- Parashtesë për dy.
- Çifte në pragje.
- Gjysmë lepur.
- Mund të jenë vizite dhe hyrjeje.
- Qe kosketieri jezuit.
- Një zhytës me skafander.
- Vajza e Picasso-s.
- Janë videot aspak profesioniste.
- Mirë në qendër.
- Një shumë brinjësh të shumëkëndëshit.
- James që qe këngëtare.
- Janë dukuri.
- Mund të jenë për shtyp.
- Tregohen nga termometri.
- Dhjetëv angleze.
- Faktet pa fat.
- Këndohen në opera.
- Emri i dikurshëm i Tokyo-s.
- Veshja me obi.
- Një ditë në mbledhje.
- Një ditë të lartë të tillë si kardinale.
- Ramazotti këngëtar.
- Lezet pa kufij.
- Një mund të jetë elektrike.
- Eshhtë trup pa kënde.
- Bie një me balë.
- Fitim pa kufij.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË




- Lear që këndon Tomorrow
6. Një krye të detyrës.
6. Një fis ilir.
- Ruhet në fund.
- Kurap pa zanore.
7. Metë bëhet tapë.
- Ente Furnizimi Kombëtar
- Fara këngëtare.
8. Capek që shkroi R.U.R.
- Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Inicialet e Selleck.
- Punojnë në galeri
10. Si vizuale
11. Justine aktore.

- Kufijtë e kujtesës.
12. Ishin skillevër spartanë.
- Kështu e quajti Krishti Shen Pjetri
13. Emër vajze.
- Inicialet e Munch.
14. Janë pozitive.
- Një Behar komik.
15. Takim i Biznesave Autonome
- Një peshk në luginë e Pogradeit.
16. Kryepërdënia e kananejeve.
- Jean aktor.
17. Shkruhet në mars.
- Kendon Vissi s'arte

- VERTIKAL**
1. Gjijet në Luginën e Shkodrës.
- Janë ara të punuara por të pamjellë.
2. Eshhtë reforma me tokën.
- Një mund të jetë dritë.
3. Skuadra merengue
- Një është Mirel Josa.
4. ... Oriol, shkruar nga Maupassant
- Dedukur pjesërisht.
5. Një vaj i yni
- Një zakon.

FJALËKRYQI SPORTIV



- Lewandowski-t.
35. Fili në traditën.
37. Një mendim.
40. Ente Autonome Berat.
42. Personazhi në foto.
48. Personazhi në foto

VERTIKAL

1. Fili në masat
2. Eshhtë loka buke.
3. Në fillim të javës.
4. Lajçi te Inter.
5. Një episod telefilm.
6. Një ndriques në makinë.
7. Agjendi Transporti Civil
8. Janë litarët e Tarzanit.
9. Inicialet e Munch.
10. Ishin rapso të Homerit.
11. Tutor pa zanore
14. Ndërrohen në pjesën e dytë.
15. Rilidhur pjesërisht.
18. Një ekspres në binarë.
21. Dashi kr s'është ai.
22. Në këtë cast.
26. Depot pa kufij
25. Campbell mbrojtës anglez.
28. Një përgjigje në celular.
27. Një pjesë e emisioneve
28. Ente Zyrat Italiane.
29. Alberto ish-skiator.
30. Nijon Luka.
32. Ai në pasqyrë.
34. Paul Eluard.
36. Manaj sulmues i yni.
37. Një halor është pisha
39. Ente Ndërtimi Përmet
41. Pak akademike.
42. Ekstremitë në gabime.
43. Mbyllin takimin
44. Laik kur s'është ai.
45. Ekstremitë në motel.
46. Qendër në kaos.
47. Louis Pasteur

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV




HORIZONTAL


1. Andej nga parakalohe.
7. Një shok armësh.
12. Eshhtë lloj papagalli.
13. Bëhen me trëpësh nën kosh.
16. Një lëvizje me... muletë.
17. Fili drejt.
19. Josia trainer.
20. Një pjesë e ndeshjeve.
23. Maldini që qe trainer.
28. Kufizon një tender.
29. Mund të jetë antidoping.
31. Shpërthejë kundër arbitrimëve të tilla.
33. Fili në goditjen.
34. Eshhtë përfaqësuesja e

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË
MËNYRË QË ÇDO RRESHT E
KOLONË TË KETË NUMRAT NG 1-9



PËRGJIGJE



HOROSKOPI

DASHI

Qelli i dashurisë se çifteve do kthellohet edhe me tepër gate kësaj dite. Dielli do rlinde dhe ambienti do ngrohet mjaftueshëm. Priten momente të këndshme. Beqaret do mendojnë gate gjithë kohës për dashurinë dhe karrezit të lëndohen nëse nuk gjejnë personin e ëndrrave. Ne planin financiar do jete Jupiteri ai qe do sjelle fat dhe prosperitet. Situata do vijin duke u përmirësuar.

LUANI

Do keni divergjenca te forta sot me partnerin tuaj dhe ne disa momente mund te mendoni edhe te ndaheni prej tij. Mire është te mos nxitohen, por te bëni durim. Beqaret do bëjnë mire t'a lënë gjat kohës sepse kane për te pasur një jete me te kënaqeshe. Ne planin financiar do jete Jupiteri ai qe do sjelle fat dhe prosperitet. Situata do vijin duke u përmirësuar.

SHIGJETARI

Yjet do bëjnë te pamundurën qe t'iu afrojnë edhe me shume me partnerin tuaj gate kësaj dite dhe do ja arrijnë qëllimit. Pasioni do rikthehet furishëm ne jetën tuaj ne çift. Beqaret nuk do ndihen aspak mire me statusin qe kane, por nuk do bëjnë as përpjekjet e duhura për ta ndryshuar atë. Buxheti do dini si ta menaxhoni me maturi dhe situata do mbetet e mire.

DEMI

Neptuni do krijone një klime harmonike dhe te këndshme ne jetën tuaj ne çift. Nuk do keni aspak probleme me partnerin dhe do e favorizoni me tepër dialogun. Beqaret me shume gjase do hedhin hapa me tej me një person qe kane pak kohe qe e kane njohur. Edhe financat do jene te mira. Nëse nuk tregoheni impulsive me shpenzimet keni për tu pasuruar shpejt.

VIRGJËRESHA

Marrëdhënia ne çift do jete shume e paqëndrueshme sot. Here do debatojeni fort me partnerin dhe here do dashuroheni plot pasion me te. Beqaret do e kërkojnë ne vendin e gabuar princin e tyre te kaltër dhe nuk do mund ta gjejnë dot atë. Me financat duhet te bëni sa me shume kujdes sepse i gjithë terreni ka për te qene i minuar sot. Mendoni edhe për te ardhmen.

BRICJAPI

Nen ndikimin negativ te Plutonit sot do shihen mosmarrëveshjet me partnerin. Do jeni gate gjithë kohës ne stres te madh dhe nuk do dini çfarë hapash te hidhni. Beqaret sado qe te mundohen nuk do arrijnë dot ta ndryshojnë statusin. Gjendja e financave do vazhdoje te mbetet e mire. Do i menaxhoni me kujdes paratë qe keni neper duar dhe nga ana tjetër do keni edhe mbështetjen e familjareve.

BINJAKËT

Bashkëpunimi me partnerin do forcohet edhe me tepër gate kësaj dite. Do ja kaloni mjaft mire me partnerin dhe do ju vini kapak njëherë e mire problemeve te se shkruarë. Beqaret do kenë disa konflikte te vogla ne pune dhe nuk do e kenë mendjen për te kërkuar dashurinë. Buxheti do varet tërësisht nga mënyra sesi ju do i menaxhoni te ardhurat. Po gabuat do keni probleme shume serioze.

PESHORJA

Dite harmonike dhe e mbushur me emocione te veçanta do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do ndihen mire ne çdo moment. Beqaret, ka mundësi qe nëpërmjet puntës te realizojnë disa njeje interesante, te cilat mund te shndërrohen ne histori afatgjate dashurie. Ne planin financiar planetët do kenë ndikim mjaft pozitiv. Situata sa do vije e do përmirësohet.

UJORI

Sado qe te mundohen gate kësaj dite, nuk do arriji dot ta ndryshoni jetën tuaj ne çift. Debatet do jene te njëpasnjëshme edhe pse jo aq te forta si me pare. Beqaret nuk duhet te mendohen gjate për te joshur dikë qe pëlqejnë sepse një jetë personi do tregohet me iskathe. Ne planin financiar do keni vështirësi te njëpasnjëshme dhe vetëm mbështetja e te afërmeve do ju nxjerre nga telashtet.

GAFORRJA

Edhe ata qe kane pasur probleme apo qe marrëdhënia ne çift ju është ftohur, sot do kalojnë një dite pozitive. Te dy palët do i shohin gjerat me një sy tjetër. Beqaret do jene tejet ëndërrimtare dhe mund te zhgënjehen nga realiteti. Me e mira do jete te qëndroni me këmbë ne toke. Ne planin financiar do jeni te logjikshëm dhe do dini gjithmonë si t'i menaxhoni te ardhurat.

AKREPI

Ka rrezik qe jete jeta juaj ne çift te ndërlikohet një mase sot. Nuk do bëni as lëshimin me te vogël ndaj partnerit tuaj dhe nga ana tjetër do kërkojeni gjerat te pamundura prej tij. Beqaret nga ana tjetër do kenë sukses ne dashuri dhe shume gjerat do ju ndryshojnë. Ne planin financiar bëjini me kujdes llogaritë nëse nuk doni qe te mbeten pa para brenda pak ditësh.

PESHQIT


Dite intensive do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Ne çdo moment do mendojnë te bëjnë gjerat interesante ne mënyrë qe rutina te shmanget. Beqaret do e adhurojnë pafund një person dhe mund te bëjnë sakrificat për ta bërë për vete. Ne mbërrijnë te marrin atë qe dëshirojnë. Ne planin financiar do keni shume fat, por duhet te bëni kujdes me çdo shpenzim.

PËRGJIGJE



SHKRONJA
E NJËTË
PËR NUMËR
TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR



Alba MALLTEZI - DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP ; Aurel PEPA - ZV/KRYEREDAKTOR
Genc KONDI- ADMINISTRATOR I SHËRGJITHSHËM; Admira PEÇI- KRYEREDAKTORE E "RILINDASI";

DESIGN: Altin ALIAJ, Erjon YMERI, SPËRNDARJA: Spiro MESHINI CEL: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: shqiptarja.com@hotmail.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

Departamenti i Marketingut:
Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Abonohu!



[SHQIPTARJA.com]

origjina e lajmit...

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:



POSTA SHQIPTARE

Tel: 042 375 598 ; 04 237 55 98 ; **Cel:** 066 20 17 771
abonime@postashqiptare.al



AGJENCIA E ABONIMIT TË SHTYPIT

Tel: 04 422 11 08 ; **Cel:** 066 20 47 825
arben.trenova@yahoo.com



ADRION LTD

Tel: 04 22 40 018 ; **Cel:** 069 40 36 824
sales@adrionltd.com

